# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5887
E mërkurë, 25 shtator 2019
çmimi 0.40 €


## Presidenti Thaçi kërkon njohjen e Kosovës nga Selia e Shenjtë FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"





FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI FAQE 4-5



# JA PSE PDK-ja DUHET DHE DO T'I FITOJË ZGJEDHJET

Profesori dhe anëtari i Këshillit Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ibrahim Gashi, ka bërë me dije se PDK-ja është oferta më e sigurt për të ardhmen e qytetarëve të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se të gjitha subjektet e tjera që më 6 tetor i ofrohen qytetarit të Kosovës si alternativë kanë të meta. Teksa ka treguar se pse duhet dhe do të fitojë PDK-ja edhe këtë herë, Gashi ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje deri më tani e ka mohuar shtetin e Kosovës, LDK-ja nuk ka treguar guxim për vendime të mëdha, kurse AAK-ja ka sjellë ftohjen e raporteve me ShBA-në

SOT (E MËRKURË) DO TË NISË FUSHATA ZYRTARE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT FAQE 3

# Nis 'beteja' zyrtare për mbledhjen e votave



Subjektet politike dhe kandidatët e tyre për deputetë nga sot (e mërkurë) deri më 4 tetor do ta shpalosin programin e tyre për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Gjatë këtyre dhjetë ditëve nëpërmjet takimeve dhe tubimeve të ndryshme ata do të përpiqen t'i bindin qytetarët për t'i votuar. Prishtina, Mitrovica dhe Theranda janë qytetet që partitë politike kanë përzgjedhur për ta bërë hapjen zyrtare të fushatës zgjedhore. Ndërkohë KQZ-ja, PZAP-i dhe BE-ja kanë bërë thirrje për fushatë të qetë dhe demokratike



## Nënshkruhet kontrata për jetësimin e Spitalit të Prishtinës FAQE 7

## OPINION

### PDK-JA NË KOALICION ME LIGJIN E ME SOVRANIN PËR T'I ELIMINUAR SHPËRDORIMET F. 10-11

Hasan MUJAJ



## AKTUALE



### LIMAJ: DREJTËSIA, ARSIMI DHE SHËNDETËSIA DO TË PËSOJNË REFORMA TË THELLA NË QEVERISJEN TIME F. 7

### KOALICIONI AAK - PSD FOKUS DO TA KETË ZHVILLIMIN EKONOMIK F. 7

### RRGK-JA BËN THIRRJE: VOTONI PËR MË SHUMË GRA NË KUVEND F. 3

## EKONOMI

### ODA EKONOMIKE AMERIKANE PREZANTON REKOMANDIMET PËR QEVERINË E RE F. 8

### AKP-JA SHPALLI SHITJEN E RE TË ASETEVE PËRMES LIKUIDIMIT NR. 51 F. 8

## SPORT

### PRISHTINA SYNON VAZHDIMËSINË E FITOREVE, DUKAGJINI BEFASINË F. 14


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepcisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Presidenti Thaçi kërkon njohjen e Kosovës nga Selia e Shenjtë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ka zhvilluar një takim me sekretarin e Shtetit të Selisë së Shenjtë, Pietro Parolin. Thaçi ka thënë se njohja formale e Kosovës nga Selia e Shenjtë do ta kurorëzonte krejt angazhimin e saj për sigurimin e paqes dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë

EPOKA E RE Qendresa RAMA



NJU JORK, 24 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ka zhvilluar një takim me sekretarin e Shtetit të Selisë së Shenjtë, Pietro Parolin. Presidenti Thaçi fillimisht e ka falënderuar atë për mbështetjen që Selia e Shenjtë i ka dhënë popullit të Kosovës para, gjatë dhe pas luftës. Ai ka thënë se njohja formale e Kosovës nga Selia e Shenjtë do ta kurorëzonte krejt angazhimin e saj për sigurimin e paqes dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë. "Populli i Kosovës gjithmonë është udhëhequr nga vlerat e Shën Terezës, vlera të tolerancës, paqes dhe bashkëjetesës. Jemi mirënjohës për mbështetjen që Selia e Shenjtë i ka dhënë popullit të Kosovës. Krejt çfarë ka mbetur është njohja nga Vatikani", ka shtuar presidenti Thaçi.
Presidenti Thaçi e ka informuar sekretarin Parolin për harmoninë fetare në Kosovë, për bashkëjetesën ndërmjet komuniteteve, vlera mbi të cilat është ndërtuar shteti i Kosovës.
Ndrësa sekretari i Shtetit i Selisë së Shenjtë, Pietro Parolin, ka thënë se Selia e Shenjtë është e përkushtuar për paqen, tolerancën dhe stabilitetin në Kosovë.
Në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, presidenti Thaçi do të ketë takime të shumta me përfaqësues të shteteve pjesëmarrëse në këtë eveniment.

# Thaçi: Është koha që Kosova dhe Greqia t'i thellojnë marrëdhëniet

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka takuar të martën kryeministrin e ri të Greqisë, Kyriakos Mitsotakis. Thaçi ka thënë se është koha që Kosova dhe Greqia t'i thellojnë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. "Është koha që Kosova dhe Greqia t'i thellojnë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Kryeministrin e ri të Greqisë, Kyriakos Mitsotakis, e kam falënderuar për mbështetjen që ky shtet i ka dhënë Kosovës në perspektivën euroatlantike. U pajtuam që t'i shikojmë mundësitë e rritjes së bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

LAJME SHKURT

## ShBA: Për zyrtarët e korruptuar, ndryshimi që sjellim është një lajm i keq



TIRANË, 24 SHTATOR - "Jo të gjithë ndajnë qëllimet tona për të përmirësuar zbatimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë në Shqipëri. Për zyrtarët e korruptuar, ndryshimi që ne po sjellim është një lajm i keq. Është si rëra në ingranazhe, e cila shumë shpejt do bëjë që aktivitetet e tyre korruptive të ndalen", u shpreh zëvendës shefi i Misionit në detyrë Dan Koski gjatë aktivitetit mbi Projektin për Planifikimin dhe Qeverinë Vendore të USAID/Albania.
Më tej Koski bëri thirrje të mos shkurajohen sepse në horizont është një e ardhme më e ndritur për Shqipërinë, transmeton oranews.
"Ne e dimë se ata do të luftojnë dhe do të përpiqen në çdo moment t'i bllokojnë përpjekjet tuaja për të çuar përpara këto qëllime të rëndësishme. Mos u stepni. Mos u shkurajoni. Vazhdoni të qëndroni në këmbë dhe të luftoni për reformat që do të forcojnë shoqërinë shqiptare për ju dhe brezat e ardhshëm. Ju besoni që në horizont është një e ardhme më e ndritur për Shqipërinë. Të njëjtën gjë mendojmë edhe ne, dhe do ta vijojmë këtë rrugëtim së bashku me ju", tha Koski.

## Opozita merr pjesë në reformën zgjedhore



TIRANË, 24 SHTATOR - Opozita ka vendosur t'i përgjigjet pozitivisht ftesës së OSBE-së për të marrë pjesë në tryezën e diskutimeve për reformën zgjedhore. Në mbledhjen e PD-së me aleatët, ku merrnin pjesë krerët e gjithë partive të frontit opozitar, u vendos që opozita të përfaqësohet në këtë tryezë. OSBE-ja do të mbajë sot (e mërkurë) konferencën për reformën zgjedhore me temë "Të mohuar nga sistemi: ngritja e një sistemi gjithëpërfshirës për mbrojtjen e demokracisë". Pjesë e kësaj tryeze, veç opozitës reale do të jenë dhe përfaqësuesit e PS-së dhe deputetë që pretendojnë opozitën në Kuvend.
Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, pasi ka dalë nga mbledhja e aleatëve deklaroi se vendi është në një krizë të përgjithshme dhe se për këtë fajin e ka Edi Rama dhe jo opozita. Ajo u shpreh se opozita ka qenë gjithmonë konstruktive dhe ka kërkuar daljen nga kriza dhe gjetjen e një zgjidhje për normalizimin e situatës. "Mbledhja ishte që të vëmë në dijeni ambasadorin për problemet që ka në Shqipëri. Opozita nuk ka qenë asnjëherë problemi për krizën, por problemi ka qenë kjo maxhorancë me në krye Edi Ramën. Opozita e ka votuar reformën në drejtësi. Opozita ka propozuar amendamente në parlament, që nuk janë miratuar. Nëse do të ishin miratuar, do kishim sot SPAK dhe byronë e hetimit. Mund t'ju kujtoj edhe ligjin për vettingun në polici", tha kryetarja e LSI-së.
Kryemadhi u shpreh se kriza sot nuk është vetëm në politikë, por edhe në çështje të tjera, me të cilat shqiptarët përballen çdo ditë. "Opozita është e gatshme për t'i hapur negociatat me BE-në, sepse ne jemi pro për një Shqipëri evropiane. Kriza nuk është vetëm parlamenti, por edhe situata ku ndodhen shqiptarët. Opozita ka ngritur grupe për të zgjidhur krizën. Ajo që opozita do të propozojë nuk është për të zgjidhur krizën vetëm të Ramës, por krizën për shqiptarët", tha Kryemadhi.
Në njoftimin e OSBE për tryezën thuhet se kjo organizatë ndërkombëtare dhe Komisioni i Posaçëm Parlamentar për reformën zgjedhore do të mbajnë sot (e mërkurë), më 25 shtator 2019, konferencën "Të mohuar nga sistemi: ngritja e një sistemi gjithëpërfshirës për mbrojtjen e demokracisë".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Sot (e mërkurë) do të nisë fushata zyrtare për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit

# Nis 'beteja' zyrtare për mbledhjen e votave

Subjektet politike dhe kandidatët e tyre për deputetë nga sot (e mërkurë) deri më 4 tetor do ta shpalosin programin e tyre për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Gjatë këtyre dhjetë ditëve nëpërmjet takimeve dhe tubimeve të ndryshme ata do të përpiqen t'i bindin qytetarët për t'i votuar. Prishtina, Mitrovica dhe Theranda janë qytetet që partitë politike kanë përzgjedhur për ta bërë hapjen zyrtare të fushatës zgjedhore. Ndërkohë KQZ-ja, PZAP-i dhe BE-ja kanë bërë thirrje për fushatë të qetë dhe demokratike



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 24 shtator** - Ndonëse partitë politike që nga shpallja e zgjedhjeve të parakohshme kanë mbajtur takime elektorale, megjithatë sot (e mërkurë) do të fillojë fushata zyrtare për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Hapja e 'betejës' për mbledhjen e votave do të bëhet me tubime të mëdha në Prishtinë, Mitrovicë dhe Therandë. Kësisoj, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) hapjen e fushatës zgjedhore do ta bëjë në Mitrovicë në sheshin e qytetit në orën 17:00, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë në orën 19:00 do ta mbajë tubin kryesor, kurse Lëvizja Vetëvendosje (LV) do ta hapë fushatën në Sallën e Sporteve "Minatori" në Mitrovicë në orën 16:00. Koalicioni AAK - PSD fushatën elektorale do të nisë në Therandë në Palestrën e Sporteve "13 Qershori" me fillim nga ora 17:30, ndërkaq koalicioni Nisma-AKR-PD tubimin elektoral do ta mbajë në Sallën '1 Tetori' në orën 18:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) u ka bërë thirrje subjekteve politike që të zhvillojnë fushatë të qetë dhe demokratike duke i respektuar rregullat zgjedhore dhe ligjin. Edhe kryetarja e Panelit Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Gyltene Sylejmani, ka bërë thirrje që partitë politike të bëjnë fushatë në përputhje me ligjin, në të kundërtën do të ndëshkohen me gjoba deri në 50 mijë euro. "Fushata zgjedhore nis nga data 25 shtator dhe vazhdon deri më 4 tetor. Gjatë kësaj kohe të gjitha subjektet politik kanë të drejtë të mbajnë tubime dhe të bëjnë fushatë të drejtë dhe në përputhje me ligjin. Po,r janë kornizat ligjore për fushat zgjedhore, vendet e lejuara dhe të gabuara të fushatës zgjedhore. PZAP-ja mund të shqiptojë gjoba deri në 50 mijë euro", ka thënë Sylejmani.

Edhe drejtuesi i koalicionit të organizatave joqeveritare për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" (DnV), Ismet Kryeziu, ka ftuar subjektet politike dhe kandidatët që garojnë në zgjedhje të zhvillojnë fushatë të përgjegjshme dhe demokratike, duke evituar shkeljet e kodit dhe dispozitave e tjera ligjore për zgjedhjet. "Subjektet politike duhet të përmbahen nga gjuha denigruese dhe seksiste e shpërfaqur në përballjet e tyre që nga shpërbërja e Kuvendit, sepse ajo mund të nxisë urrejtje, dhunë dhe tensionim të ambientit politik. DnV-j kërkon nga subjektet politike të mos shfrytëzojnë resurset dhe asetet publike për qëllime të fushatës zgjedhore, të mos angazhojnë shërbyesit publikë në fushatë dhe të mos organizojnë pjesëmarrje të fëmijëve në tubime elektorale. Ato, po ashtu, duhet ta shmangin vendosjen e materialeve propagandusee në hapësirat publike ku është e ndaluar me ligj", ka deklaruar Kryeziu.

Ai ka treguar se DnV-ja ka mobilizuar 72 vëzhgues afatgjatë për t'i përcjellë aktivitetet e subjekteve politike, përfshirë shpenzimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. "Vëzhguesit e DnV-së do të fokusohen në vlerësimin e respektimit të kodit të mirësjelljes nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre në garë, i cili mundëson krijimin e kushteve për një fushatë të barabartë, korrekte dhe demokratike. Për më tepër, DnV do t'i monitorojë mediet dhe hapësirën që ato ua japin subjekteve politike, kandidatëve për kryeministër dhe atyre për deputetë në fushatë", ka theksuar Kryeziu.

## BE-ja bën thirrje që procesi zgjedhor të mbahet në mënyrë të qetë

Bashkimi Evropian (BE) ka bërë thirrje që partitë politike dhe udhëheqësit e tyre të sigurojnë fushatë respektuese të përqendruar në programe konkrete në interes të popullit të Kosovës. Sipas BE-së, procesi zgjedhor duhet të mbahet në mënyrë të qetë, transparente dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe sundimin e së drejtës. "Zgjedhjet janë një prej komponentëve themelorë të demokracisë. Ato janë një mundësi për popullin e Kosovës për ta ushtruar të drejtën e tyre demokratike për të votuar dhe zgjedhur udhëheqësit e vet. BE-ja bën thirrje që procesi zgjedhor të mbahet në mënyrë të qetë, transparente dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe sundimin e së drejtës. Të gjitha partitë politike dhe udhëheqësit e tyre duhet të sigurojnë fushatë respektuese të përqendruar në programe konkrete në interes të popullit të Kosovës", është thënë në deklaratën e kryesuesve të misionit të Bashkimit Evropian (EOM) që ka ardhur për t'i vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Sipas kësaj deklarate, forcimi i procesit zgjedhor është pjesë thelbësore e ciklit zgjedhor dhe me rëndësi të madhe në Kosovë. "BE-ja dhe OSBE-ja bashkërisht e kanë mbështetur themelimin e një komisioni ad hoc të Kuvendit dhe të një grupi këshillëdhënës për këtë çështje. I ftojmë të gjitha palët t'i marrin me seriozitet përpjekjet e komisionit dhe ta përshpejtojnë punën pas zgjedhjeve për t'i zbatuar rekomandimet e EU EOM", është theksuar në këtë deklaratë për medie.

## RrGK-ja bën thirrje: Votoni për më shumë gra në kuvend

**Prishtinë, 24 shtator (ER)** - Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka mbajtur të martën takim koordinues me organizatat anëtare dhe vullnetarët që janë pjesë e fushatës "Voto për më shumë gra në parlament". Rreth 200 vullnetarë për pesë ditë (25-29 shtator) do të bisedojnë me qytetarë duke shkuar derë me derë në mbi 15 komuna të Kosovës, përfshirë komunat serbe, për të diskutuar me gratë dhe burrat votues mbi rëndësinë e votimit të më shumë grave në zgjedhjet e parakohshme parlamentare që do të mbahen më 6 tetor.




Këto aktivitete janë vazhdimësi e vizitave që RrGK-ja tashmë ka bërë në disa qytete. Përmes këtyre vizitave përfaqësuese të organizatave anëtare të RrGK-së u kanë shpërndarë qytetarëve broshura dhe kanë bashkëbiseduar me ta për rëndësinë e zgjedhjes së më shumë grave në parlament.

Në fillim të këtij takimi, Igballe Rogova, drejtoreshë ekzekutive e RrGK-së, ka njoftuar të pranishmit se përmes kësaj fushate po kërkohet barazi për përfaqësim në kuvend. "Meqenëse partitë politike nuk po e zbatojnë Ligjin për Barazi Gjinore, ku kërkohet 50 për qind përfaqësim i barabartë, atëherë falë kësaj fushate qytetarët kanë mundësi që të votojnë për më shumë gra në parlament dhe në këtë mënyrë ta zbatojnë këtë ligj", ka thënë Rogova.

Flet për "Epokën e re", Ibrahim Gashi

# Ja pse PDK-ja duhet dh



Profesori dhe anëtari i Këshillit Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ibrahim Gashi, ka bërë me dije se PDK-ja është oferta më e sigurt për të ardhmen e qytetarëve të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se të gjitha subjektet e tjera që më 6 tetor i ofrohen qytetarit të Kosovës si alternativë kanë të meta. Teksa ka treguar se pse duhet dhe do të fitojë PDK-ja edhe këtë herë, Gashi ka thënë Lëvizja Vetëvendosje deri më tani e ka mohuar shtetin e Kosovës, LDK-ja nuk ka treguar guxim për vendime të mëdha, kurse AAK-ja ka sjellë ftohjen e raporteve me ShBA-në

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 24 shtator** - Profesori dhe anëtari i Këshillit Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ibrahim Gashi, është shprehur i bindur në fitoren e PDK-së më 6 tetor. Ai i ka treguar arsyet pse duhet dhe do të fitojë PDK-ja në këto zgjedhje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qytetarët e Kosovës duhet t'i besojnë të kaluarës dhe vizionit për të ardhmen që ka PDK-ja dhe lidershipi i saj. "Unë listova vetëm disa arsye, edhe pse ka një listë të gjatë të tyre, që qartësisht dhe padiskutueshëm e bëjnë PDK-në në këtë proces zgjedhor ofertën më të sigurt për të ardhmen e vendit dhe liderin e saj kryeministrin më kredibil dhe më të përkushtuar sa iu takon ndryshimeve që duhet të ndodhin, të cilat tashmë i ka shpalosur përmes 'Dekadës së Re'", ka thënë Gashi. Ai ka bërë me dije se të gjitha subjektet e tjera politike që i ofrohen si alternativë qytetarit të Kosovës më 6 tetor kanë probleme të mëdha. Sipas tij, Lëvizja Vetëvendosje deri më tani ka mohuar dhe nënçmuar shtetin e Kosovës, LDK-ja nuk ka guxuar të marrë vendime të mëdha, kurse AAK-ja me qeverisjen e saj ka sjellë ftohjen e marrëdhënieve të Kosovës me partnerët e saj strategjikë. "Bindja ime e thellë, duke e përcjell parafushatën dhe duke e njohur fuqinë reale të një strukture të konsoliduar të PDK-së, është se më 6 tetor me rezultatin e saj PDK-ja do ta bëjë diferencën e mjaftueshme sa për të mos e konsideruar se do të ketë garë të ngushtë me asnjërën nga partitë rivale", ka thënë Gashi.

**"Epoka e re":** *Z. Gashi, prej shpalljes së zgjedhjeve të*

# ...e do t'i fitojë zgjedhjet



*parakohshme subjektet politike e kanë filluar një parafushatë. Gjatë kësaj kohe çka e ka dalluar PDK-në dhe kandidatin e saj për kryeministër nga partitë e tjera?*

**Gashi:** Në dy javët e fundit kemi parë një paraqitje të kandidaturave dhe të ofertave politike për zgjedhjet e 6 tetorit. Nga të nominuarit për kryeministër shumica syresh nuk janë emra të rinj, përjashto liderin e PDK-së dhe kandidaten e nominuar nga LDK-ja. Ajo që e dallon qartësisht PDK-në dhe liderin e saj nga konkurrentët e tjerë është vizioni i qartë politik se çfarë ndryshime duhet të ndodhin në mënyrën e qeverisjes, legjitimiteti dhe fuqia e tij politike brenda subjektit që ai drejton, e dalë nga një proces i brendshëm zgjedhor (i cilësuar edhe nga të tjerët si procesi më demokratik që ka ndodhur në Kosovë, e që paraqet standard edhe për subjekte të tjera politike), vendosmëria dhe guximi i z. Veseli për t'i filluar ndryshimet, edhe para se të shpalleshin zgjedhjet e parakohshme në Kosovë, duke prekur temën deri tani më të paprekshme - atë të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Retorika që partitë e tjera tashmë një kohë të gjatë përdorin për luftën kundër korrupsionit për herë të parë u sfidua nga veprimet e PDK-së dhe kryetarit Veseli, duke tërhequr nga postet ministrat dhe zyrtarët që kishin të ngritura aktakuza. Si duket kjo që bëri PDK-ja dhe lideri i saj ishte kriter i papërballueshëm për partnerët e tjerë të koalicionit, por edhe për partitë në opozitë që kishin qenë pjesë e qeverisjeve të kaluara. Ky përcaktim i z. Veseli, me insistimin e tij dhe të subjektit që ai drejton, u bë standard edhe në kriteret për krijimin e listave të kandidatëve porsa u shpallën zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Z. Veseli dhe PDK-ja kërkoi edhe veprime të tjera konkrete të konkurrentëve politikë me rastin e shpalosjes së paktit antikorrupsion dhe ftesës për ta nënshkruar atë nga të gjithë liderët dhe partitë e tyre që garojnë në këto zgjedhje. Mirëpo kjo, siç dihet, nuk ndodhi për shkak të mosgatishmërisë së këtyre partive. Dhe ajo që bën dallimin midis PDK-së dhe kandidatit të saj për kryeministër është përcaktimi i vendosur për ta çuar përpara agjendën dhe forcuar pozicionin ndërkombëtar të Kosovës në përputhje me fundamentet kushtetuese, partneritetin me ShBA-në dhe vendet kryesore të BE-së, për ta përmbyllur procesin e dialogut me Serbinë me një epilog që forcon pozicionin e shtetit të Kosovës në OKB, si anëtare me të drejta të plota dhe i hap rrugë përafrimit me procesin e integrimit në BE dhe në NATO.

Unë listova vetëm disa arsye, edhe pse ka një listë të gjatë të tyre që qartësisht dhe padiskutueshëm e bëjnë PDK-në në këtë proces zgjedhor ofertën më të sigurt për të ardhmen e vendit dhe liderin e saj kryeministrin më kredibil dhe më të përkushtuar sa i takon implimentimit të ndryshimeve që duhet të ndodhin, të cilat tashmë i ka shpalosur përmes "Dekadës së Re".

**"Epoka e re":** *Pse duhet ta votojnë edhe një herë PDK-në qytetarët e Kosovës?*

**Gashi:** Jetëgjatësia e partive politike vlerësohet, në radhë të parë, për nga vendimet që ato marrin për të mirën e vendit. Provenienca e konceptit politik dhe lidershipit të PDK-së është shumë specifike. Rrënjët e këtij koncepti politik lidhen me veprimin më të vendosur mbrojtës, përmes një luftë çlirimtare, në një periudhë kur populli shqiptar i Kosovës po përballej me rrezikun e shfarosjes dhe me një veprim jo të armatosur, por diplomatik dhe negocues (në Rambuje), duke e vendosur Kosovën në krah të shteteve më demokratike të botës të cilat me një veprim të armatosur, të parin e këtij lloji, përmbysën planet serbe për një Kosovë pa shqiptarë. Lufta e armatosur dhe diplomatike për ta mbrojtur vendin është testi më i vështirë për ta kaluar një parti dhe lidershipi i saj. Ndryshe, emrat e liderëve të mëdhenj botërorë, Roosevelt, Truman, Ajzenauer, Churchil, De Gol dhe partitë që ata drejtuan nuk do të ishin fituese edhe pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore për dekada me radhë. Pra kjo çështje e një besimi të krijuar në periudhën e sfidave më të rënda. Kjo që thashë është dëshmia e parë pse duhet besuar vetëm PDK-së. Në procesin e definimit të statusit, përmes bisedimeve të Vjenës, atëbotë si parti në opozitë, PDK-ja esencialisht pati rol kryesor për ta arritur maksimumin e asaj që mund të arrihej në një momentum ndërkombëtar të vështirë, ku po matej fuqia e shteteve demokratike në krye me ShBA-në dhe BE-në dhe shteteve jodemokratike në krye me Rusinë e cila po shënonte një rifuqizim të saj.

Shpallja e pavarësisë (17 shkurt 2008), ku PDK-ja dhe lidershipi i saj pati rol substancial, nuk shënoi, megjithatë, fundin e problemeve për Kosovën. Lufta për ta minuar shtetin e Kosovës dhe për ta penguar afirmimin e tij ndërkombëtar vazhdoi dhe po vazhdon nga ana e shtetit të Serbisë dhe miqve të saj. Kjo duhet të jetë arsyeja e tretë pse duhet besuar vetëm PDK-së dhe Kadri Veselin që ta drejtojnë Kosovën në etapën për konsolidimin e shtetit të Kosovës, në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Nëse i dëgjojmë me vëmendje të gjithë liderët sa joseriozë janë karshi shtetit nuk e kemi të vështirë të përcaktohemi (nëse jemi të papërcaktuar akoma) se kënd duhet të votojmë.

Si ofertë politike që i ofrohen zgjedhësit të Kosovës më 6 tetor kemi parti që e mohuan, s'e njohën dhe për më shumë e nënçmuan tash e dhjetë vjet shtetin e Kosovës dhe tani me një retorikë false dhe më shumë hipokrizi harrojnë atë që kanë thënë dhe kërkojnë votën, duke thënë se vetëm ata mund ta shpëtojnë shtetin e Kosovës. Qytetarët duhet ta dinë se në vijimësi jo vetëm që e kanë mohuar atë, por e kanë nënçmuar, madje edhe sulmuar edhe miqtë dhe partnerët që ndihmuan në gjitha fazat bërjen e shtetit të Kosovës. Kemi, po ashtu, parti të tjera që vetën e mbajnë si parti institucionaliste, por që asnjëherë, përveç kur e kanë pasur në ballë të qeverisjes PDK-në, nuk kanë guxuar të marrin vendime. Për pasojë të njëjtit e kanë penguar ndryshimin e Kushtetutës për themelimin e Ushtrisë së Kosovës. Një parti tjetër që si udhëheqëse e qeverisë së fundit solli ftohjen e marrëdhënieve të Kosovës më partnerët strategjikë, në radhë të parë me ShBA-në, por edhe me vendet e tjera të BE-së. Edhe në fushatën zgjedhore kjo parti nuk i ka shumë të qarta sfidat që ka Kosova në konsolidimin e shtetësisë së saj, veçmas në planin ndërkombëtar.

**"Epoka e re":** *Por, rivalët politikë të PDK-së numërojnë shumë arsye se pse kjo parti duhet të shkojë në opozitë. Sa të qëndrueshme janë ato arsye?*

**Gashi:** Për fat të keq nuk ka asnjë arsye të qëndrueshme. Përkundrazi, asnjë nga konkurrentët politikë nuk kanë arritur dhe nuk po arrijnë ta konkurrojnë vizionin qeverisës që PDK-ja ka lansuar nëpërmjet "Dekadës së Re". Pamundësia e tyre që të konkurrojnë me vlera, ide dhe vizion qeverisës me PDK-në i ka vënë ata në pozicione nihiliste mohuese dhe akuzuese për t'i mbuluar deficitet e tyre.

**"Epoka e re":** *Edhe kësaj here shumica e subjekteve politike PDK-së i kanë vendosur vija të kuqe. Si e keni parë një veprim të tillë të këtyre partive? Pse po ndodh kjo?*

**Gashi:** PDK-ja nuk ka vënë vija të kuqe për asnjë nga konkurrentët e vet. Ajo i ka vënë vijë të kuqe ndërhyrjes së Serbisë në punët shtetërore të Kosovës dhe korrupsionit dhe nepotizmit. Nuk është retorikë, por përcaktim i vendosur i kryetarit dhe kryeministrit të ardhshëm të Kosovës, z. Kadri Veseli.

**"Epoka e re":** *Parashikimet janë se më 6 tetor do të kemi një garë të ngushtë mes disa subjekteve politike. Sipas jush, kë do ta ketë rival kryesor PDK-ja dhe çfarë do ta bëjë dallimin?*

**Gashi:** Bindja ime e thellë, duke e përcjell parafushatën dhe duke e njohur fuqinë reale të një strukture të konsoliduar të PDK-së, është se më 6 tetor me rezultatin e saj PDK-ja do ta bëjë dallimin e mjaftueshëm sa për të mos e konsideruar se do të ketë garë të ngushtë me asnjërën nga partitë rivale.

# Nënshkruhet kontrata për jetësimin e Spitalit të Prishtinës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU




PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka marrë pjesë të martën në ceremoninë e nënshkrimit të kontratës për studimin e fizibilitetit për Spitalin e Prishtinës. Kjo kontratë, e cila është nënshkruar në mes të ministrit të Administratës Publike, Mahir Jagxhillar dhe përfaqësueses së kompanisë gjermane me renome botërore, ICME, Andrea Kdolsky, do të hyjë në fuqi menjëherë. Kompania gjermane, përveç studimit të fizibilitetit, do ta hartojë edhe planin e këtij projekti. Me këtë rast, ministri Uran Ismaili ka thënë se kjo është një kontratë e shumëpritur nga qytetarët e Prishtinës. "Brenda pak muajve kompania gjermane me renome ndërkombëtare do të ketë të gatshëm studimin e fizibilitetit që do të na tregojë nevojat dhe kapacitetin e spitalit, pastaj do të hartojë edhe planin për ta nisur ndërtimin e një spitali të cilin qytetarët e Prishtinës e kanë pritur për një kohë të gjatë", ka thënë ministri Ismaili.

Përfaqësuesja e kompanisë gjermane ICME, Andrea Kdolsky, e cila ishte ministre e shëndetësisë e Austrisë, ka thënë se është nderuar që ta nisë edhe këtë projekt në të mirë të shëndetësisë së Kosovës. "Jam e nderuar që do të punoj me ministrin Ismaili i cili është një vizionar dhe që në këtë projekt do të ketë përkrahë një njeri ideal nga Administrata Publike si ministri Jagxhillar. Do ta sjellim përvojën tonë më të mirë ndërkombëtare në shtetin tuaj në lidhje me Spitalin e Prishtinës", ka thënë Kdolsky.

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, i ka uruar të gjithë qytetarët e Prishtinës duke thënë se ky është një projekt i rëndësishëm për krijimin e shërbimeve më të mira shëndetësore. Për periudhën trevjeçare 2019-2021 janë ndarë 7 milionë euro për ndërtimin e këtij spitali me mundësi të shtimit të buxhetit nëse studimi i fizibilitetit thotë se ky spital do të kushtojë më shumë.

# Kryhen dy rastet e para me laparaskop në Kirurgjinë Pediatrike



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Në Klinikën e Kirurgjisë Pediatrike në QKUK u realizuan dy intervenimet e para me kirurgji minimale invazive me laparaksop. Rasti i parë ka qenë një 13-vjeçar, i cili ishte i diagnostikuar si varicocele e testitit (zgjerim i venave të testitit) të anës së majtë. Intervenimi është kryer me sukses dhe pacienti është liruar në shtëpi në gjendje të mirë, pas vetëm një ditë qëndrimi në spital.

Rasti i dytë një pacient i moshës 10 vjeç, i diagnostikuar si cholelithiasis (gurë në fshikëzën e tëmthit). Pacienti është liruar pas dy ditë qëndrimi në spital, në gjendje të mirë shëndetësore. "Kjo metodë e operimeve ka shumë përparësi në raport me operacionet kirurgjike klasike sepse është me invazion minimal. Pacientët e operuar pas operacionit e marrin veten shumë më shpejt, u kthehen aktiviteteve normale të jetës, kurse ulet shkalla e invaliditetit dhe kostoja e hospitalizimit", është thënë në njoftimin e QKUK-së.

Stafi mjekësor i Klinikës së Kirurgjisë Pediatrike, përfshirë kirurgët pediatrikë, anesteziologët dhe stafin e mesëm shëndetësor, do të vazhdojnë të kryejnë operacione me metoda të tilla minimale invazive.

# FSK-ja, pjesë e ushtrimit ndërkombëtar 'Saber Junction 19' në Gjermani

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Një kontingjent i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), i përbërë nga oficerë dhe nënoficerë, dy ekipe mjekësore dhe një ekip i Kompanisë për Operacione Civile (KOC), që nga data 10 shtator deri më 30 shtator po merr pjesë në ushtrimin fushor ndërkombëtar "Saber Junction 19" , i cili po realizohet në bazën amerikane "Hohenfels" të Gjermanisë. Pjesëtarët e kontingjentit të FSK-së u janë bashkangjitur njësive amerikane, sipas misionit të tyre, duke operuar në detyrat e tyre specifike.

Krahas Divizionit të Parë të Këmbësorisë së ushtrisë amerikane dhe asaj të Kosovës, në këtë ushtrim po marrin pjesë edhe mbi 5 400 trupa nga shumë vende të botës, si: Armenia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Italia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Polonia, Rumania, Turqia dhe Ukraina.

Ekipet e mjekësisë të FSK-së janë angazhuar për trajtimin e të lënduarve, evakuimin e viktimave dhe mbështetje të tjera mjekësore. Ndërsa ushtarakët e KOC-it janë duke realizuar operacione me civilët. Si njësi e re e krijuar, gjatë operacioneve të këtij ushtrimi, janë mbështetur vazhdimisht nga ekipet e specializuara në fushën e operacioneve civile të ushtrisë amerikane.



## Limaj: Drejtësia, arsimi dhe shëndetësia do të pësojnë reforma të thella në qeverisjen time




PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga koalicioni Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë të martën në debatin e organizuar nga Kongresi Kombëtar i të Rinjve. Në këtë debat, Limaj ka thënë se sistemi i drejtësisë, ai i arsimit dhe i shëndetësisë do të hasin në reforma të thella në qeverisjen e ardhshme të drejtuar nga ai. Ai ka potencuar rëndësinë që vendi duhet t'i nënshtrohet një reforme të thellë duke iu përshtatur kërkesave dhe nevojave që ka si shtet. Po ashtu, Limaj ka theksuar rëndësinë që të rinjtë, të cilët nuk kanë mundësi të kryejnë fakultete, t'u drejtohen shkollave të aftësimit profesional dhe të aftësohen për tregun e punës. "Nën qeverisjen time do të bëjmë gjithçka që është e mundur që ta mbajmë rininë në Kosovë, duke i ofruar asaj kushte sa më të mira për shkollim, përgatitje profesionale dhe punësim. Nisma Socialdemokrate ka dëshmuar këto vite se është parti që u jep hapësirë të rinjve në pozicione vendimmarrëse", ka thënë Limaj.

# Koalicioni AAK - PSD fokus do ta ketë zhvillimin ekonomik

**Kandidati për deputet i PSD-së, Visar Ymeri, ka theksuar se koalicioni AAK - PSD ka paraparë disa masa nëpërmjet të cilave do të mbështetet zhvillimi i hovshëm ekonomik. Sipas tij, masë kryesore e këtij koalicioni është fondi zhvillimor**




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), bashkë me partneren e koalicionit, Partinë Socialdemokrate (PSD), kanë mbajtur të martën konferencën e radhës për media, në të cilën kanë prezantuar pjesë nga programi qeverisës për zhvillimin ekonomik të vendit, me përfaqësuesit Visar Ymeri nga PSD-ja dhe Muhamet Spahiu nga AAK-ja, të dy njohës dhe ekspertë të ekonomisë.

Ymeri ka theksuar se koalicioni AAK-PSD ka paraparë disa masa përmes të cilave do të mbështetet zhvillimi i hovshëm ekonomik. Masë kryesore, ka thënë ai, është fondi zhvillimor, për të cilin ka dhënë informacione shtesë për planin e ngritjes dhe zbatimit. "Ne i kemi paraparë disa masa përmes të cilave ekonomia e Kosovës do ta ketë një rritje të hovshme të zhvillimit krahasuar me vitet e deritashme. Një prej masave kryesore është fondi zhvillimor. Fondi zhvillimor është një entitet të cilin do ta themelojmë menjëherë pasi ta themelojmë qeverinë me kryeministër Ramush Haradinaj dhe i cili do të jetë entitet i pavarur, i themeluar nga Kuvendi, i qeverisur sipas praktikave më të mira të qeverisjes korporative dhe i mbikëqyrur nga Kuvendi i Kosovës", ka deklaruar Ymeri.

Spahiu ka folur edhe për masa të tjera që kanë të bëjnë me mbështetjen financiare të bizneseve dhe lehtësirave fiskale për to. Ai ka theksuar se bizneset prodhuese do të jenë në fokus të qeverisë së re, të cilave do t'u zvogëlohen taksat sipas numrit të punëtorëve që rekrutojnë. "Përveç fondit të punësimit dhe fondit të zhvillimit, të cilit i kemi dhënë pak theks më të rëndësishëm dhe më të qëndrueshëm te programi 100 %, do të ndërmerren edhe një sërë masash të cilat kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje financiare dhe lehtësira në politikat fiskale. Duke filluar prej politikave fiskale, kuptohet që fokus kryesor do të jenë bizneset prodhuese. Bizneseve prodhuese do t'u ulen taksat në të ardhura personale për çdo të punësuar të ri", është shprehur Spahiu.

Ymeri dhe Spahiu dhanë edhe të tjera hollësi për programin ekonomik të koalicionit AAK - PSD dhe iu përgjigjën pyetjeve të gazetarëve lidhur me temën për të cilën ishte thirrur konferenca, pa lënë anash edhe pyetjet për çështje të tjera.

## Kurti prezanton programin për rininë




PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër, Albin Kurti, ka bashkëbiseduar të martën me të rinjtë për programin e kësaj lëvizje për rininë në Kongresin Kombëtar të Dytë të të Rinjve të Kosovës. Duke iu përgjigjur shqetësimeve të të rinjve mbi korrupsionin dhe papunësinë nga njëra anë dhe jetën e varfër sociale e kulturore nga ana tjetër që po i shtyjnë ta braktisin Kosovën, kandidati për kryeministër ka prezantuar masat kryesore të Lëvizjes Vetëvendosje mbi arsimin dhe zhvillimin ekonomik. Kurti ka theksuar se skema e punësimit të garantuar për 16-18 vjeçarët, ringritja e një rrjeti shkollash të mesme profesionale, afrimi i universiteteve me praktikat për studentët dhe 1 000 bursat për vajzat me prioritet studentet e shkencave të natyrës janë vetëm disa nga nismat që rinia jonë ta jetojë Kosovën si projekt të së ardhmes së tyre. "Pa rininë ndryshimet janë arnime të të njëjtit realitet. Me rininë ndryshimet e transformojnë realitetin", ka thënë Kurti.

# Veseli: Prodhuesve do t'ua subvencionojmë deri në 80 për qind interesin e kredive

**Prizren, 24 shtator (ER)** - Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, të martën është takuar me disa fermerë në Prizren. Ai ka thënë se në qeverisjen e tij do të kenë përkrahje shumë më të madhe. "Njerëzit që punojnë tokën janë kudo njerëzit më të përkushtuar dhe më të ndershëm. Të tillë janë edhe fermerët tanë, që me mund dhe djersë mbajnë familjet e tyre. Fermerët e Prizrenit, që sot i takova, por edhe të gjithë Kosovës, në qeverisjen time do të kenë përkrahje shumë më të madhe. I kuptojmë nevojat e tyre, prandaj edhe do t'i rrisim investimet në sistemet e ujitjes, do ta rrisim kapitalin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive dhe do t'ua subvencionojmë deri në 80 për qind interesin e kredive për prodhim. I kuptojmë rreziqet e punës, prandaj edhe do t'i sigurojmë produktet bujqësore dhe do të investojmë më shumë në ndërtimin e infrastrukturës moderne për grumbullimin, ruajtjen dhe paketimin e prodhimeve bujqësore", ka thënë Veseli pas këtij takimi. Ai ka theksuar se prodhimet bujqësore të tokës sonë do t'i përkrahim dhe në tregun e brendshëm përmes Ligjit të Përkrahjes së Produkteve Vendore.



# 'Adria Airways' ka pushuar përkohësisht fluturimet më 24 dhe 25 shtator

**Prishtinë, 24 shtator (ER)** - "Adria Airways" ka njoftuar se më 23 shtator në mesnatë ka pushuar përkohësisht operimin e shumicës së fluturimeve më datat 24 dhe 25 shtator, edhe fluturimet e Adrias në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". "Adria Airways" ka këshilluar udhëtarët e saj që ta verifikojnë transportuesin e tyre përpara se të arrijnë në aeroport dhe nëse është "Adria Airways", atëherë t'i kontaktojnë zyrat e tyre të shitjes. "Adria Airways" rekomandon që udhëtarët dhe partnerët e saj t'i ndjekin njoftimet e tyre në internet në www.adria.si.
Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës është duke e monitoruar situatën e krijuar rreth operimit të kësaj kompanie dhe do t'ju informojë për zhvillimet e reja.



# Oda Ekonomike Amerikane prezanton rekomandimet për qeverinë e re

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Vazhdimi i reformës në mjedisin e të bërit biznes, i cili do ta mundësonte fuqizimin e sektorit privat dhe tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, duhet të jetë prioritet i Qeverisë së re të Kosovës.

Anëtarët e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë besojnë se përmirësimi i sundimit të rendit e të ligjit, adresimi i boshllëkut të infrastrukturës transportuese dhe energjetike, si dhe boshllëkut i fuqisë punëtore duhet të jenë në thelb të kësaj reforme, ndërsa krijimi i një strategjie nacionale të zhvillimit ekonomik duhet të jetë pikënisja e kësaj reforme ashtu si edhe e të gjitha vendimeve në kuadër të qeverisjes ekonomike të Kosovës. "Qeveria e ardhshme e Kosovës duhet të demonstrojë me veprime konkrete angazhimin e saj për një zhvillim më të hovshëm të Kosovës, duke garantuar një ekonomi të tregut me konkurrencë të lirë si bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht duke bërë të mundshëm angazhimin e të gjitha kapaciteteve të ndërmarrjeve të brendshme dhe atyre të jashtme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Strategjia nacionale e zhvillimit ekonomik do të duhej të ishte ndër dokumentet e para të prodhuara nga qeveria e re, duke pasuar një studim të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës të kapaciteteve dhe mundësive të vendit, duke përfshirë këtu edhe sektorët strategjikë në të cilët duhet të bazohet zhvillimi i qëndrueshëm i vendit", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Sipas OEAK-ut, rol të rëndësishëm në këtë aspekt mund të japë sektori privat dhe asociacionet e biznesit përmes mekanizmave formalë të dialogimit.

Anëtarët e Odës Amerikane besojnë se zbatimi i mirëfilltë i kuadrit ligjor është faktori më i rëndësishëm në të bërit biznes, ndërsa themelimi i një gjykate të veçantë komerciale duhet të trajtohet me prioritet nga ana e qeverisë së re, duke u ofruar kështu bizneseve një mekanizëm më efikas për zgjidhje të kontesteve. "Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të garantojë trajtim të barabartë të të gjitha ndërmarrjeve dhe të gjithë sektorëve në vend", është thënë në komunikatën e kësaj ode.

Për ta matur ndikimin dhe efikasitetin që iniciativat e reja ligjore mund të kenë në sektorin privat, por edhe në sferat e tjera të jetës, sipas OEAK-ut, qeveria e re duhet të aplikojë në vazhdimësi vlerësimin e ndikimit rregullativ si praktikë instrumentale në shtetet e BE-së, e cila paraqet një sistem për vlerësimin kritik të efekteve pozitive dhe negative të akteve të propozuara, duke formuar kështu një metodë të politikëbërjes e cila bazohet në prova. "Qeveria e re duhet të avancojë në aplikimin e standardeve të harmonizuara të raportimit financiar si për korporatat e mëdha, po ashtu edhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që në kthim do të mundësonte efikasitet dhe transparencë më të madhe, por edhe mundësi më të madhe për identifikimin e nevojave të tregut, politikëbërje më të denjë që merr në konsideratë nevojat e sektorit privat, informimin më të mirë, rritje të partneriteteve të investitorëve të brendshëm me investitorët e jashtëm si dhe ulje të mëtejme të kostos së kapitalit. Për këtë është e nevojshme edhe përpunimi periodik i të dhënave elektronike nga ana e Këshillit Kombëtar për Raportim Financiar", është theksuar në këtë komunikatë.



OEAK-u ka theksuar se qeveria e re duhet të vazhdojë ta mbështesë zhvillimin e infrastrukturës transportuese në vend, ku theks i rëndësishëm duhet dhënë modernizimit dhe zgjerimit të rrjetit hekurudhor, por edhe funksionalizimit të Aeroportit të Gjakovës, ndërsa investimi në akset e reja rrugore duhet të pasojë studimet e kujdesshme të fizibilitetit. Po ashtu, OEAK-u ka pohuar se qeveria e re duhet ta mbështesë zgjerimin e kapaciteteve të gjenerimit të energjisë elektrike, por edhe diversifikimin e burimeve të energjisë në Kosovë. Në këtë aspekt, Oda Amerikane mbështet ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", por edhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave për ndërtim të kapaciteteve energjetike nga burimet e ripërtëritshme. "Vëmendje e rëndësishme nga qeveria e re duhet kushtuar zhvillimit të kapitalit njerëzor, duke filluar nga reformimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet e tij, duke nisur nga ai parafillor, me qëllim të nxitjes së ndërmarrësisë në mesin e gjeneratave të ardhshme, por edhe përmirësimin e raportit ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës. Qeveria duhet të përmbahet nga veprimet që thellojnë hendekun e pagesave ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, përmes ngritjes së mëtejme të pagave në sektorin publik, duke e reduktuar më tej disponueshmërinë e fuqisë punëtore brenda sektorit privat, në pamundësi të ndjekjes së trendëve të pagesave në sektorin publik. Ndërsa në anën tjetër, legjislacioni i punës duhet të jetë në linjë me nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit, duke mos rënduar rregullimin e raporteve ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Oda Ekonomike Amerikane beson se qeveria e re duhet ta kompletojë bazën ligjore të vendit, në ato fusha ku për momentin ngulfaten inovacioni dhe avancimi biznesor, siç është rasti me transaksionet elektronike, duke u bazuar gjithnjë në strategjinë nacionale të zhvillimit ekonomik, e cila do të duhej hartuar që në ditët e para të mandatit të ri.

## AKP-ja shpalli shitjen e re të aseteve përmes likuidimit nr. 51

PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) zyrtarisht ka shpallur shitjen e aseteve përmes likuidimit nr. 51. Lista e tenderëve për privatizim me këtë valë të shitjeve përmban 125 asete/njësi atraktive të ndërmarrjeve shoqërore në Republikën e Kosovës, të cilat paraqesin një mundësi të shkëlqyer për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në vendin tonë. "Kjo valë e shitjeve me të gjitha asetet e tenderuara është aprovuar në Bordin e Drejtorëve, kurse AKP-ja i ka njoftuar paraprakisht të gjitha komunat përkatëse se këto asete të ndërmarrjeve shoqërore do të privatizohen dhe ka shpallur njoftimin për tender në faqen e saj të internetit dhe në mediat e shkruara dhe ato elektronike", është bërë me dije në njoftimin e AKP-së.

AKP-ja ka njoftuar se ofertat e mbyllura për njësitë/asetet që janë në shitje përmes shitjes së aseteve me likuidim nr. 51 duhet të dorëzohen në sallën e konferencave në "Grand Hotel" në Prishtinë më 23 tetor nga ora 10:00 deri në orën 12:00, të shoqëruara edhe nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, ashtu siç është parashikuar për secilin artikull. "Kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë, duke filluar nga ora 12:30", thuhet në njoftimin për media të AKP-së.



## Kryetari Jashari: Nuk do të lejojmë që qytetarëve t'u shiten produkte me afat të skaduar

SKENDERAJ, 24 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë të martën se si kryetar komune nuk do të lejojë që qytetarëve t'u shiten produkte me afat të skaduar. Ky reagimi tij ka ardhur pasi Drejtoria e Inspektoratit në këtë komunë ka hasur në produkte me afat të skaduar në njërin prej marketeve. "Drejtoria e Inspektoratit, gjatë kontrolleve që ka bërë nëpër qendra tregtare dhe markete të ndryshme në qytet, ka hasur në produkte me afat të skaduar në njërin prej marketeve në qytet, përkatësisht në marketin 'Tradita tregtare', pastaj e ka bërë konfiskimin e mallit dhe e ka asgjësuar atë. Ndaj pronarit është shqiptuar gjobë në përputhje me dispozitat ligjore. Gjithmonë do të jemi të përkushtuar për mbrojtje të konsumatorit", ka thënë kryetari Jashari.



# Edhe Peja bëhet me instalime të reja dhe moderne të linjave 35 kV



PEJË, 24 SHTATOR (ER) - Në nënstacionin Peja 1 në qytetin e Pejës, KEDS-i ka përfunduar projektin e instalimit dhe të modernizimit të linjave 35 kV (kilovolt). Mbi 30 punëtorë të kompanisë janë angazhuar për kryerjen e këtyre punimeve për energjizimin e stabilimenteve të reja 35 kV.

Secila prej këtyre linjave prek një numër të madh të konsumatorëve, prandaj edhe përfitimet janë të mëdha. Këto përfitime fillojnë nga fakti që janë shumë më të sigurta se ato paraprake e duke vazhduar në atë që ndërprerjet eventuale si pasojë e faktorëve të ndryshëm parashihet të jenë shumë më të vogla. "Paralelisht me rinovimin e linjave është bërë edhe modernizimi i tyre. Tashmë aty çdo gjë do të jetë automatike. Dhe meqenëse projektet kanë përfunduar, në këto nënstacione parashihet të instalohet sistemi scada, me ç'rast mundëson komandimin nga distanca. Ky sistem tashmë është instaluar në Distriktin e Ferizajt dhe është në funksion", është thënë në njoftimin e KEDS-it.

Projekti në nënstacionin Peja 1 është vazhdim i projekteve të implementuara në distriktin e Gjilanit, Ferizajt dhe Gjakovës.

# Bytyqi njoftohet me problemet e shkollës 'Gjon Serreçi' në Ferizaj

FERIZAJ, 24 SHTATOR (ER) - Ministri në detyrë i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, i shoqëruar edhe nga drejtori i Komunal i Arsimit (DKA) në Ferizaj, Afim Llabjani, kanë vizituar shkollën "Gjon Serreçi", me ç'rast nga afër janë njoftuar në lidhje me problemet me të cilat është duke u ballafaquar kjo shkollë. Me këtë rast, Bytyqi ka thënë se janë duke shqyrtuar mundësinë që kjo shkollë të punojë në dy ndërrime, duke siguruar një objekt të ri ose nxënësit të barten në ndonjë shkollë tjetër. "Sot së bashku me drejtorin e DKA-së erdhëm ta vizitojmë Shkollën Fillore 'Gjon Serreçi' në Ferizaj. Përveç asaj që është një vizitë në shkollë, ne kemi ardhur edhe për disa shqetësime të cilat kanë ardhur nga prindërit dhe shoqëria civile për të parë nga afër se cila është gjendja në këtë shkollë. Kjo shkollë ka një traditë. Ne diskutuam gjatë edhe me drejtorin e DKA-së dhe me drejtorin e shkollës pasi që kjo shkollë ka një numër të madh të nxënësve dhe është me tri ndërrime dhe diskutuam për një mundësi që këtë shkollë ta kthejmë në dy ndërrime", ka thënë Bytyqi.

Ndërsa drejtori i Arsimit në Ferizaj, Afrim Llabjani, ka thënë se edhe pse shkolla ka një infrastrukturë të vjetërsuar, suksiset e nxënësve të kësaj shkolle asnjëherë nuk kanë munguar. "Kjo shkollë ka shumë nxënës dhe një infrastrukturë të vjetërsuar, por nuk mungojnë rezultatet e sukseseve asnjëherë. E kemi informuar ministrinë që jemi në ndërtim e sipër të një shkolle e cila planifikon dhe mundëson kalimin e shkollës 'Gjon Serreçi' në shkollën 'Shaban Hashani', ndërsa ata të kalojnë në shkollën e re. Ne do ta krijojmë ata hapësirë e cila do të jetë e mjaftueshme për shkollën 'Gjon Serreçi' dhe do të krijohen kushte më të mira për një proces normal", ka thënë Llabjani.



Ndërsa drejtori i Shkollës Fillore "Gjon Serreçi", Nazmi Heta, ka thënë se me ndihmën e Ministrisë së Arsimit do t'ua sigurojnë nxënësve një hapësirë më të madhe.

## Dëmtohet pllaka e varrezave protestante në Gjilan

GJILAN, 24 SHTATOR (ER) - Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës ka bërë me dije të martën se disa persona e kanë dëmtuar pllakën që shënonte vendvarrezat e tyre në Komunën e Gjilanit. Sipas një reagimi, si bashkësi shprehin indinjatën dhe shqetësimin në lidhje me demolimin dhe dëmtimin e pllakës. Për këtë veprim ka reaguar edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj). KMDLNj e ka dënuar këtë veprim duke e quajtur vandal. "KMDLNj e dënon këtë veprim vandal që drejtohet ndaj një komuniteti fetar në Kosovë dhe i cili, sipas ligjeve në fuqi, i gëzon të gjitha të drejtat për përmbushjen e detyrimeve fetare si dhe komunitetet e tjera fetare. KMDLNj përkujton opinionin se Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës deri më tani ka hasur në vështirësi në disa komuna për sigurimin e lokacionit për varrezat e që KMDLNj disa herë ka reaguar publikisht në mbështetje të kërkesave të tyre të drejta sikur edhe ka kërkuar nga autoritetet të sigurohet një lokacion për varreza. KMDLNj kërkon hetim të shpejtë dhe vënie para organeve të drejtësisë të atyre që iu dëshmohet përgjegjësia për këtë akt të shëmtuar", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.



Aktuale

# PDK-ja në koalicion me ligjin e me sovranin për t'i eliminuar shpërdorimet

Qeveria, me kryeministër Kadri Veselin, nuk do t'i lejojë më punësimet pa kritere ligjore dhe mbi bazën e ndërhyrjeve korruptive, politike, farefisnore, familjare, partiake etj. Ky shpërdorim eklatant ka marrë shtrirje të gjerë, sidomos në vitet e fundit



Hasan MUJAJ

Votimi është obligim ligjor, është obligim kushtetues, demokratik, etik dhe shtetëror. Ai është akt vendimtar për të formuar institucione legjitime që burojnë nga vullneti i lirë i qytetarëve për ta drejtuar dhe për ta zhvilluar shtetin me arritje risimtare. Pikërisht për këtë arsye në shtetet më të zhvilluara dhe me demokraci të mirëfilltë, këtij procesi (votimit) i kushtohet vëmendje e posaçme nga institucionet përkatëse, por edhe nga qytetarët dhe zyrtarët kompetentë të vendit. Vendin parësor në garën parazgjedhore e zgjedhore të shteteve me traditë të gjatë demokratike e zënë temat që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të shtetit, me projekte të realizueshme që të ngrihet standardi i jetës së qytetarëve, që të hapen vende të reja të punës, ekspozohen parashikimet studimore të zhvillimit të së ardhmes etj.

Zgjedhjet e gjashtë tetorit në Kosovë janë të jashtëzakonshme. Si të tilla, janë të rëndësishme; tejet të rëndësishme për zhvillimet e reja politike të Kosovës; tejet relevante për politikën e jashtme e të brendshme të Kosovës; shumë të vlefshme për t'i mënjanuar disa dukuri negative që kanë marrë shtrirje të gjerë në Kosovë, të cilat e kanë komprometuar shtetin edhe në relacionet ndërkombëtare si vend ku nuk zbatohet ligji. Prandaj, edhe përgatitjet për zgjedhjet duhet të jenë shumë konstruktive e ligjore ashtu sikundër edhe dalja në votime duhet të jetë masive.

Temat e sipërshtruara, në fushatën parazgjedhore e zgjedhore të Kosovës, sikundër mund të shihet nga paraqitja e programeve të disa partive politike, zënë vend shumë të vogël ngase vendin qendror në fjalimet e disa liderëve dhe të poltronëve të tyre nuk e kanë projektet me interes për mirëqenien e qytetarëve, porse mbizotëron propaganda me premtimet shterpë, me akuzat dhe etiketimet për oponentët politikë, shpeshherë edhe me shpifje e trillime të ndryshme, me fjalime panegjirike që u referohen liderëve të partive politike edhe pse pa ndonjë meritë të veçantë etj.

Shteti duhet të vihet mbi interesin privat të secilit. Ky është kriter i demokracisë, përfillja e të cilit nuk do të lejonte që të vërshojnë shpërdorimet e ndryshme dhe veprimet anarkike; për këtë është më se i mbëhishëm edukimi demokratik dhe, mbi të gjitha, zbatimi i ligjit që të mos gjejnë terren shtrirjeje dukuritë negative si: korrupsioni, nepotizmi, antivlera, interesi, përfitimi personal etj. Dhe, përderisa nuk luftohen këto dukuri, s'është habi që në institucionet e larta të shtetit do të emërohen njerëz të paaftë, se do të propozohen e do të votohen për deputetë njerëz që nuk dinë të flasin as të shkruajnë si duhet në gjuhën amtare madje në foltore shihet se kanë vështirësi të mëdha për ta gjuhëzuar mendimin, se votohen njerëz me të kaluar të dyshimtë politike, se lejohet e mundësohet të futen në politikë njerëz pa kapital elementar politik, etik retorik, sociokulturor, demokratik, linguistik etj.

M. F. Kuintiliani, edukatori dhe oratori virtuoz, për fjalimin publik, shkroi: "Fjalimi bazohet në ligjet e gjuhës". Më se e vërtetë kjo. Ai ose ajo që nuk e di gjuhën standarde, nuk është për foltore, dmth. nuk është për deputet/e! Nga ky kënd vështrimi, është shumë domethënës edhe mendimi i filozofit italian Benedeto Kroçe: "Quaj njeri atë që është zot i gjuhës amtare!"

Dhe, qytetari ynë i voton njerëzit e këtillë sepse voton sipas sugjerimeve të të tjerëve, voton pa e ditur rëndësinë e votimit dhe pa e vlerësuar kandidatin; për ta votuar dikë, duhet ta vlerësosh lart të kaluarën dhe të sotmen e tij ose të saj, biografinë, aftësinë dhe kontributin e saj ose të tij në fusha të ndryshme të veprimtarisë etj. Vota duhet të jetë autonome, e lirë dhe pa ndërhyrje. Kjo është e drejtë ligjore. Kjo duhet t'u bëhet e qartë të gjithë votuesve.

Fjalimet në tubimet parazgjedhore e zgjedhore duhet të karakterizohen nga retorika pozitive, nga respekti reciprok i liderëve politikë, nga fjalori selektiv, kulturor, estetik dhe etik. Ato duhet të jenë në përpjesëtim me realitetin e të zbatueshme në praktikë dhe jo premtime utopike e iluzore, romantike e euforike hiperbolash manipuluese ngjashëm me përmbajtjen e këngëve legjendare. Disa liderë partish politike mendojnë shumë gabimisht se do të ngrihen lart duke i kritikuar kundërshtarët politikë në fushatën zgjedhore madje edhe me epitete fiktive dhe duke bërë vetëlavdërime! Stil të këtillë, filistin e steril, ndaj homologëve përdorin vetëm ata që nuk kanë kapital kognitiv në kompetencë për të zgjedhur stilin në performancë; vetëm ata që nuk dinë se është ngritur një shkencë e re ndërdisiplinare e quajtur stilistika e zgjedhjes.

Kompetenca kulturore, etike dhe intelektuale dëshmohet nga formulimet gjuhësore që përdor lideri në komunikimin publik. Ajo kap shumë fusha e fushëza ndër të cilat edhe të ashtuquajturën higjienë e gjuhës në kuptimin etik dhe të respektit ndaj atij që i referohet oratori.

Për postet më të larta drejtuese, sikundër është pozita e kryeministrit, në çdo shtet është kusht i patejkalueshëm përvoja e punës pararendëse në ndonjë pozitë udhëheqjeje. Dhe, me shumë të drejtë ngase, shprehur me metaforа, askush nuk mund të kërcejë nga shkalla e parë në tarracën lart; duhet të kalohen disa shkallë. Në asnjë shtet nuk rastis të nominohet për kryeministre ose për kryeministër kandidatja apo kandidati pa asnjë ditë përvojë pune në ndonjë pozitë drejtuese. Kjo ngjet vetëm në Kosovë! Habi e madhe! Veprim shumë i papërkorë i atyre që i nominojnë dhe i atyre që i pranojnë kandidaturat. Mund të jetë edhe temë atraktive për emisionet humoristike. Ky pranim përkon me humorin popullor kur njëri, derisa kalonte pranë aeroportit, e pyet tjetrin: "A ta kish marrë menja me nisë ballonën? - Nuk e kam provu kurrë, po ma kish marrë menja me nisë!" Ky komunikim mund të shërbejë si qesëndi funksionale me ndonjë kandidat për kryeministër.

Mungesa e përvojës në pozitat e larta drejtuese shihet qartë edhe nga përmbajtja e fjalimeve publike, të cilat shquhen nga premtimet hiperbolistike e utopike, nga miopia politike e kiç vlera praktike, fjalime patriotike e glorifikuese me patos të romantizmit të shek. XIX kur parashtroheshin kërkesa për të zgjuar e thelluar vetëdijen kombëtare. Askush nuk mund të krijojë emër nga fama e ish-liderëve të autoritetshëm dhe nga bëmat e tyre me vlera të larta e të padiskutueshme. Secila parti politike duhet ta ndërtojë identitetin e vet dhe ta vërë atë në funksion të zhvillimit të shtetit.

Nga deficiti i përvojës dhe i pjekurisë politike, në një fjalim publik drejtuar elektoratit para ca ditësh, ndër të tjera, u tha: "Ju lus për mobilizim si në vitet e '90-ta sepse shteti ynë është në rrezik!" Parë nga këndi i pragmasemantikës mund të kuptohet se në këtë periudhë ka inkongruenca koherente e logjike të përpilimit të tekstit të fjalimit politik. Krahasimi i zhvillimeve politike i viteve të 90-ta në Kosovë me të tashmen është shumë komik, absurd dhe i paqëndrueshëm. Asokohe ishte i domosdoshëm një homogjenizim kombëtar për të përmbysur diktaturën komuniste të Beogradit zyrtar dhe për të shtrirë puhizën e demokracisë edhe në Kosovë. Nëse në mendimin e kontestuar konkurrenca e partive politike shihet si rrezik për shtetin, atëherë mund të flitet për nostalgjinë ndaj komunizmit, për përjashtimin e pluralizmit politik si tipar i demokracisë që gjeneron cilësi dhe për kthimin në monizëm! Kandidatja për kryeministre apo kandidati për kryeministër nuk kanë të drejtë ta ftojnë popullin për mobilizim edhe nëse, si thuhet, "vendi është në rrezik!" Për këtë lloj mobilizimi janë institucionet e shtetit të obliguara sipas Kushtetutës së shtetit. Pra, vetërrëfim i deficitit të kognicionit elementar të funksionimit të shtetit juridik!

Vota në sistemin demokratik nuk fitohet me lutje, por me vlera, me projekte konkrete të zhvillimit të shtetit, me zbatimin e ligjshmërisë për t'i zhdukur dukuritë kriminale etj.

## Projekti i PDK-së po pritet krahëhapur e me galdim

PDK-ja është vënë e tëra në shërbim të sendërtimit të kërkesave reale të qytetarëve të Kosovës. Për ta trupëzuar këtë synim, ajo, nga ekspertë të spikatur dijesh të ndryshme të vendit e ndërkombëtarë, hartoi një projekt të gjerë, praktik e të thukët shtetëror e nacional, i cili zuri të vegojë, të parashtrohet e të demonstrohet nga lideri i partisë, zotëri Kadri Veseli në takimet me qytetarët për t'u tumirur kudo me shendim.

Projekti i ri i PDK-së, së pari, spikat paprekshmërinë e kufijve në të cilët Kosova është shpallur shtet i pavarur dhe i njohur ndërkombëtarisht për të vazhduar më tej: sovraniteti i Kosovës është i pacenueshëm; respektimi absolut i Kushtetutës së Kosovës; refuzimi i prerë i tendencës së politikës serbe për të krijuar minishtet në shtet etj.

Në programin qeverisës të PDK-së vëmendje e veçantë i kushtohet zbulimit dhe luftimit të korrupsionit përmes shërbimit të quajtur antikorrupsion, i themeluar nergut ndesh kësaj dukurie në Kosovë; korrupsioni, sidomos ai i nivelit të lartë, është bërë pengesa e patejkalueshme e mosinvestimeve të huaja në Kosovë madje edhe dukuri e komprometimit të shtetit në arenën ndërkombëtare si vend ku nuk funksionon ligji, si vend ku korrupsioni është mbi ligjin. Dihet rasti i reagimit të biznesmenëve gjermanë, të cilëve u janë kërkuar tre milionë euro si kusht pararendës për të investuar në Kosovë!

Qeveria me kryeministër Kadri Veselin nuk do t'i lejojë më punësimet pa kritere ligjore dhe mbi bazën e ndërhyrjeve korruptive, politike, farefisnore, familjare, partiake etj. Ky shpërdorim eklatant ka marrë shtrirje të gjerë, sidomos vitet e fundit. Në projektin në vështrim zhvillimi i ekonomisë me të gjitha nënfushëzat e saj është prioritet qeveritar; shteti do t'i favorizojë bizneset e ndryshme të mëdha dhe të vogla me zvogëlim tatimesh; nga investimet e jashtme e të brendshme do të hapen vende të reja pune, sidomos për të rejat e të rinjtë me kualifikimet përkatëse; do të ketë investime në modernizimin e shëndetësisë dhe do të bëhet sigurimi shëndetësor i qytetarëve; mënjanimi i ndikimit të politikës në sistemin e drejtësisë dhe zbatimi i përpiktë i ligjshmërisë në gjykata; ngritja e cilësisë në arsimin e të gjitha niveleve mbi bazën e kritereve të shërbimit të mbikëqyrjes profesionale e ndryshime të tjera që stimulojnë dhe avancojnë kualitetin e mësimit si p. sh. zgjedhja e drejtorëve të shkollave nga instancat profesionale të vetë shkollave që të mos ketë drejtorë të diktuar nga kryetarët e komunave sipas kriterit të përkatësisë partiake sikundër veprohet tani!

Barazia gjinore, si një kriter i BE-së, në Kosovë ende nuk është në shkallë të duhur. Ajo, sipas platformës politike të PDK-së, parashihet të ngrihet shumë më lart: femrat duhet të jenë të përfaqësuara në të gjitha institucionet dhe pozitat drejtuese madje, për të arritur kriterin e barazisë, në kushtet e barabarta të kualifikimit, duhet të kenë përparësinë e pranimit. Ligji për barazinë gjinore nuk do të jetë vetëm në letër, por do të ekzekutohet në vepër. **(Vijon)**

E rrallë

# E ngatërron me derrin, djali qëllon për vdekje babanë



Një djalë ka qëlluar për vdekje babanë e vet derisa po gjuanin derra në Itali. Ata po ecnin në një pyll me shkurre pranë qytetit Postiglione në provincën jugore të Salernos të dielën që kaloi kur ndodhi vrasja. 34-vjeçari hapi zjarr kur pa një hije dhe gjethet duke lëvizur, duke qëlluar babanë e vet në bark. Menjëherë shkoi në ndihmë të tij, kur kuptoi se çfarë kishte ndodhur dhe u përpoq ta mbante gjallë të atin, raporton "BBC". Por mjekët nuk mund të bënin dot asgjë për ta shpëtuar 55-vjeçarin Martino Gaudioso.

FOTO E DITES




Fëmijët luajnë me një celular në një treg në New Delhi në Indi. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Mjekët nuk gjejnë shërim për 22-vjeçaren që nxjerr kristal nga sytë



Rasti i një vajze 22-vjeçare nga Armenia ka habitur mjekët. Satenik Kazaryan u shfaq në spital me dhimbje të tmerrshme që shkaktohen nga kristalet që nxjerr nga sytë. "Isha te dentisti dhe m'u duk sikur më hyri pluhuri në sy. Kjo më lëndoi. Shkova tek oftalmologjisti dhe më dolën disa kristale nga sytë. Tani jeta ime e përditshme është kthyer në makth", ka thënë ajo. Vajza është e shqetësuar se lotët e kristaltë mund të jenë shenjë e problemeve më serioze. Por, fatkeqësisht, nuk bën dot trajtime më të thelluara pasi familja është e varfër.

## BARSOLETA E DITËS



Dy policë po ecnin në një rrugë. Në një çast shohin një fëmijë duke pirë cigare dhe e pyesin:
- Në cilën klase je?
- Në klasë të dytë.
Një nga ta fillon ta qortojë, kurse tjetri i thotë:
- Çfarë është me ty? Ti nuk pije cigare kur ishe në klasë të dytë?
- Po, por unë kisha 18 vjet.

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00

### Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

**Regjia:** Josh Cooley







Në ora 18:00 dhe 20:00

### AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray

Çdo ditë në ora 22:00

### DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

**Regjia:** Michael Engler




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Për të lindurit e kësaj shenje është dita e duhur për të nisur 'e-mail'-et e lëna pas dore.



**DEMI** Mund t'ju komunikojnë diçka gabim por, fatmirësisht, do të rezultojë në favorin tuaj.



**BINJAKËT** Ekziston mundësia që të përballeni me një dramë gjatë javës që vjen.



**GAFORRJA** Ekziston mundësia të keqkuptoheni teksa rrëfeni diçka me shumë sinqeritet. Kjo nuk do të thotë që të shqetësoheni, duke e vështirësuar edhe më tej situatën.



**LUANI** Keni kaluar ditë të lodhshme kohët e fundit në punë, por sot do të ndiheni shumë më mirë.



**VIRGJËRESHA** Mund të ndiheni të shqetësuar për shkak të marrëdhënies suaj me një prej kolegëve.



**PESHORJA** Mund të kaloni një ditë të qetë në punë, por nuk përjashtohet mundësia që të tensionoheni në situata të caktuara.



**AKREPI** Sot mund të mos keni dëshirë të komunikoni shpesh. Qëndroni të qetë dhe veproni ashtu sikurse dëshironi.



**SHIGJETARI** Përgjithësisht do të jetë një ditë e mirë, por mund ta ndieni mungesën e emocioneve, pasi asgjë e re nuk po ndodh.



**BRICJAPI** Lidhjet tuaja me disa kolegë në punë mund të shkojnë edhe më tej. Kjo mund të jetë diçka pozitive. Provoni.



**UJORI** Një lajm të cilin kishit kohë që e prisnit, më në fund do të vijë te ju.



**PESHQIT** Do të jetë një ditë e ngarkuar dhe mund të jeni paksa mbrapa me planet tuaja.

# Legjenda e rokut mbush 70 vjet



Bruce Springsteen nuk ka pasur asnjëherë një hit numër një në klasifikim, nuk ka shitur aq albume sa Billy Joel e nuk ka aq ndikim sa Elvis Presley apo Chuck Berry. Por 'bosi', siç e quan "CNN", ka mbushur 70 vjet, është pothuajse ylli më i nderuar amerikan i rokut në të gjithë kohët. Bob Dylan shihet më shumë si këngëtar popullor. Gjatë karrierës së tij prej pesë dekadash, Springsteen ka fituar 20 çmime Grammy, një Oscar, dy Golden Globes, një çmim special Tony dhe është nderuar nga Kennedy Center, pa llogaritur edhe çmimet e shumta MTV Video Music Awards.

# Martohet DJ Tiwsto



DJ Tiwsto u martua me të dashurën e vet, modeluesen Annika Backes, të shtunën në një shkretëtirë në Utah. "Dashuria e jetës sime 21-09-2019", ka shkruar në rrjetet sociale artisti 50-vjeçar poshtë fotografisë me nusen e vet 21-vjeçare. Ceremonia me 80 persona u zhvillua në një shkretëtirë në Utah, në vendpushimin luksoz Amangiri, ku dhëndri kishte të veshur një kostum Tom Ford dhe nusja një fustan Berta.



# Ja pse Joe Jonas nuk e shoqëroi Sophie Turner në Emmy Awards

Sophie Turner u nominua për një çmim Emmy të dielën që lamë pas, por bashkëshorti i saj Joe Jonas nuk ishte i pranishëm me të. Megjithatë, ai ka një arsye pse mungoi. Vëllezërit Jonas aktualisht janë në turne dhe po atë mbrëmje ata patën një koncert në Kansas City, Misuri. Joe i shkroi një mesazh gruas së tij në "Instagram": "Unë jam shumë krenar për ty. Ti je nominuar për një Emmy. Je e pabesueshme. Të dua". Por, Sophie nuk ia doli të fitojë.

# Lenny Krevitz kërkon ndihmë për syzet e humbura



Ylli i rokut Lenny Kravitz ka pyetur ndjekësit në llogarinë e vet në "Twitter" nëse ata mund ta ndihmojnë t'i gjejë një palë syze të cilat i ka humbur, duke ndarë një fotografi të tij për t'u treguar si duken. "Më humbën këto syze dielli pas shfaqjes sime në LA këtë fundjavë", ka shkruar muzikanti. "Ato janë tepër sentimentale për mua, janë të cilësisë së mirë dhe i përkisnin një anëtari të familjes", ka shkruar më tutje Kravitz.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Prishtina synon vazhdimësinë e fitoreve, Dukagjini befasinë

FC Prishtina po synon të paraqitet dhe të shënojë fitore ndaj Dukagjinit ashtu sikurse bëri në përballjen e fundit ndaj Gjilanit, kurse me synime të mëdha drejt kryeqytetit udhëton edhe skuadra e Dukagjinit, e cila po beson se mund ta marrë maksimumin e pikëve. Kjo është ndeshja e mbetur e javës së dytë dhe zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 18:00



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ndeshja e mbetur e javës së dytë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll në mes të Prishtinës dhe Dukagjinit nga Klina do të zhvillohet sot (e mërkurë) nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri".

Trajneri i Prishtinës, Armend Dallku, i cili e mori drejtimin e kryeqytetasve ditë më parë, pas largimit të Bylbyl Sokolit, ka thënë se Prishtina synim e ka që të paraqitet edhe ndaj Dukagjinit ashtu sikurse ndaj Gjilanit. "Pas një ndeshje mjaft të mirë kundër Gjilanit, vjen testi tjetër ndaj Dukagjinit. Tani është komplet tjetër ndeshje dhe pothuajse tjetër karakter, sepse Gjilani ka qenë në krye të tabelës, ndërsa Dukagjini është në fund. Kështu që duhet t'i qasemi në mënyrë tjetër kësaj ndeshjeje. Po ashtu, po shpresoj që djemtë do të rikuperohen mjaftueshëm deri para ndeshjes, sepse kam thënë, edhe pas ndeshjes me Gjilanin, se djemtë e kanë dhënë maksimumin pas një ritmi të lartë të ndeshjes jo vetëm sipas meje, por edhe sipas analistëve dhe njohësve e dashamirëve të futbollit që e kanë cilësuar si të tillë. Të paraqitemi përafërsisht në atë nivel që u paraqitem me Gjilanin", ka thënë Dallku, i cili ka konfirmuar se në këtë ndeshje "bardhekaltërve" iu mungojnë sulmuesi Ahmet Januzi dhe mbrojtësi Ahmet Haliti.

Edhe skuadra nga Klina në këtë ndeshje do ta ketë mungesën e sulmuesit Granit Arifaj. Portieri i Dukagjinit, Flamur Neziri, ka shfaqur shumë optimizëm për ndeshjen që zhvillohet sot në kryeqytet. Ai ka bërë me dije se skuadra që ende nuk ka shënuar asnjë gol në Superligë synon fitoren në këtë përballje. "Jemi mobilizuar në të gjitha aspektet për ndeshjen e rëndësishme kundër Prishtinës. Synimi ynë është që si skuadër të luftojmë dhe të marrim fitore, edhe pse Prishtina është skuadër favorite. Kushtet që i plotëson stadiumi 'Fadil Vokrri' ta japin mundësinë që të aplikojmë lojën që dëshirojmë", ka thënë Neziri për "Epokën e re".

Pas gjashtë xhirosh të zhvilluara, Prishtina renditet në pozitën e shtatë me 7 pikë, kurse skuadra e Dukagjinit është në pozitën e fundit me vetëm një pikë të grumbulluar.

## SHKURT

### Drejtori i Fenerbahçes: Kemi një ofertë 20 milionëshe për Muriqin

Vedat Muriqi vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes në Turqi dhe Evropë. Forma e mirë e reprezentuesit të Kosovës ka bërë që shumë klube evropiane, përfshirë Manchester Unitedin dhe Juventusin, të shfaqin interesim për shërbimet e tij. Drejtori sportiv i klubit të Fenerbahçes, Damien Comolli, ka zbuluar se ka marrë ofertë prej 20 milionë eurosh për Muriqin. "Emrin e skuadrës nuk mund ta them, por mund t'ju them se oferta ka ardhur për afatin kalimtar të janarit dhe është rreth 20 milionë euro", ka thënë Comolli.

### Grezda: Kërkoj falje për veprimet e fundit

Trajneri Stiven Gerrard ka vendosur përjashtimin përfundimtar të Eros Grezdës nga Rangersi. Gjithçka lidhet me një incident të turpshëm teksa sulmuesi shqiptar luante në ekipin e të rinjve. Grezda e ka humbur tërësisht kontrollin ndaj Ballymena, duke pështyrë një nga lojtarët kundërshtar. Një nga çështjet më të komentuara kjo nga ana e medieve skoceze, ndërsa edhe vetë protagonisti e ka thyer heshtjen. Nëpërmjet një postimi në "Instagram", Grezda ka theksuar se ka edhe një anë tjetër të historisë, megjithëse e pranon se ishte e shpifur. "E pranoj plotësisht që të pështysh është e shpifur, por ka gjithmonë dy anë të historisë. Kërkoj falje për veprimet e fundit", ka shkruar Grezda.

### Shala rikthehet nga lëndimi

Kosova do t'i zhvillojë dy ndeshje të rëndësishme në muajin tetor. Më 10 tetor "Dardanët" do të luajnë ndeshje miqësore me Gjibraltarin, ndërsa katër ditë më vonë luajnë për kualifikime me Malin e Zi. Lajm i mirë është se një nga futbollistët kryesor të Kosovës në repartin e mesfushës, Herolind Shala, është rikthyer nga lëndimi. Shala kishte munguar në dy ndeshjet e shtatorit ndaj Çekisë dhe Anglisë. Mesfushori i Kosovës është aktivizuar në 25 minutat e fundit për skuadrën e tij, Valerenga, në duel me Vikingun.

### Vritet ish-basketbollisti Andre Emmett

Ish-basketbollisti Andre Emmett ka vdekur në moshën 37-vjeçare. Emmett u gjet i vrarë në mëngjesin e së hënës në qytetin e Dallas. Policia ka zbuluar detaje nga vrasja që tronditi sportin në Amerikë, duke raportuar se ai u vra nga dy persona derisa po qëndronte në makinë para shtëpisë së vet, shkruan CNN. Fillimisht gjithçka nisi si grindje, kur njëri nga personat nxori një armë dhe qëlloi Andre derisa ky po ikte. Motivi ende nuk është bërë i ditur, kurse Andre vdiq në spital. 37-vjeçari luajti në Texas Tech për katër vjet.

## Zidane nuk frikësohet nga shkarkimi

MADRID, 24 SHTATOR - Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, ka thënë se nuk mërzitet për atë se çfarë shkruajnë mediet lidhur me të ardhmen e tij. Reali e pret Osasunan të mërkurën në "Santiago Bernabeu", në kuadër të La Ligës, kurse trajneri francez paralajmëron se synim e kanë fitoren. "Kur humbim mua më shkarkojnë, kur fitojmë nuk më shkarkojnë. Kështu ka qenë gjithmonë dhe do të vazhdojë të jetë. E kemi lojën dhe çfarëdo që ndodh, ndodh. Duhet të luajmë mirë, me ritmin dhe dëshirën e njëjtë (si me Sevillën). Kjo më intereson mua", ka thënë Zidane.



## Agim Ademi takoi Alasdair Bellin, flasin për rastin e Loret Sadikut

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, gjatë qëndrimit në Milano ka takuar zëvendëssekretarin e përgjithshëm të FIFA-s, Alasdair Bell, i cili në opinionin njihet për argumentimin e shkëlqyeshëm që i dha Kongresit të UEFA-s në maj të vitit 2016 për të drejtën e Kosovës për t'u bërë anëtare e UEFA-s. Kryetari Ademi në emër të komunitetit të futbollit në Kosovë e falënderoi Bellin për respektin që ka treguar ndaj FFK-së dhe për argumentimin brilant ligjor në favor të pranimit të Kosovës në UEFA. "Bell e përgëzoj kryetarin Ademi për arritjet e deritashme dhe u shpreh i lumtur që Kosova në këta tre vjet të anëtarësimit në UEFA dhe FIFA ka bërë hapa të mëdhenj përpara dhe po tregohet storie e suksesit në çdo fushë. Temë e këtij takimi ishte edhe çështja e Loret Sadikut, i cili ende nuk ka arritur ta përmbyllë procesin rreth fitimit të së drejtës për t'u paraqitur në Kombëtaren e Kosovës. Me këtë rast, Bell theksoi se do të përkujdeset për të parë se ku ka ngecur ky proces dhe nëse mund të ecet tutje", thuhet në njoftimin e FFK-së.



# Arifi: Luajmë ndaj superfuqive, por japim maksimumin për sukses

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Të enjten ndaj Sllovenisë për Kosovën në ndeshje zyrtare do të debutojë Albana Arifi, që gjatë verës fitoi të drejtën të paraqitet me Përfaqësuesen e Kosovës. Albana, që ka të kaluar shumë të suksesshme me Suedinë, ka katër ditë që është bashkuar me përfaqësuesen dhe mezi po pret ta luajë ndeshjen e parë zyrtare me Kosovën. Albana pritet të jetë një nga lideret e Kosovës dhe të japë kontribut së bashku me vashat e tjera që të kalojnë në nivel më të lartë. Kosova të enjten luan ndaj Sllovenisë në Maribor, kurse të dielën e presim Gjermaninë në Prishtinë. "Po ndihem shumë mirë. Nuk mund ta përshkruaj me fjalë. Me padurim po e pres ndeshjen e parë kundër Sllovenisë por, mbi të gjitha, jam duke e pritur debutimin kundër Gjermanisë në Pallatin e Rinisë para publikut tonë, me shpresë që salla do të mbushet", ka thënë Albana Arifi. Ajo është e kënaqur me ekipin, punën që po e bëjnë vashat dhe selektori Agron Shabani. "Edhe pse ballafaqohemi me dy superfuqi të hendbollit botëror, unë personalisht në secilën ndeshje hyj për fitore dhe luaj 100 % deri në sekondën e fundit për fitore. E respektoj secilin kundërshtar, por nuk i frikësohemi askujt. Do ta japim maksimumin që ta bëjmë secilin kundërshtar të mos ndihet komodkur të ballafaqohet me ne", ka deklaruar Albana Arifi.




# IAAF konfirmon pezullimin e Rusisë

MOSKË, 24 SHTATOR - IAAF konfirmoi vendimin e saj për ta mbajtur të pezulluar këtë federatë që prej vitesh është përfolur për një skandal dopingu ku u përfshinë edhe autoritetet shtetërore ruse. Ishte presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Atletikës, Sebastian Coe, që bëri të ditur këtë vendim të IAAF gjatë kongresit të këtij organizmi të zhvilluar në prag të Botërorit të Atletikës që do të mbahet në Doha. Vendimin për ta mbajtur këtë dënim IAAF e mori pas raportit të Agjencisë Botërore Antidoping, sipas të cilit, ka mospërputhje me të dhënat e dërguara nga laboratorët antidoping të Moskës në muajin janar të këtij viti. Ndërkaq vetë WADA ua dha një afat trejavësh drejtuesve të laboratorëve për t'i shpjeguar këto mospërputhje te të dhënave, në rast të kundërt do të merren sanksione më të ashpra, ku nuk përjashtohet mundësia e përjashtimit të atletikës ruse edhe nga Lojërat Olimpike të Tokios Rusia u pezullua nga aktivitetet ndërkombëtare të atletikës në vitin 2015 për shkak të skandalit të dopingut që duket se kishte edhe mbështetjen e shtetit rus. Megjithatë, IAAF gjatë kësaj kohe ka toleruar të gjithë ata sportistë rusë që kanë rezultuar të pastër duke i lejuar të marrin pjesë në evenimente me flamur neutral Ndërkaq, këtë të premte nis edhe ngjarja më e rëndësishme e atletikës, Kampionati Botëror që do të mbahet në Doha të Katarit. Tashmë ky vend është në përgatitjet e fundit në pritje të këtij evenimenti ku do të garojnë mbi 1 900 atletë nga 210 vende të botës.



## SHKURT

### Shkëndija e dëshiron Panuccin

Aventura Christian Panuccit në bankinën e Kombëtares së Shqipërisë ishte zhgënjyese, por trajneri italian mund të ketë një tjetër përvojë me shqiptarët në karrierën e tij, megjithëse jo të drejtpërdrejtë. Aktualisht tekniku është i papunë, ndërsa mediet e Maqedonisë së Veriut e vendosin emrin e tij në listën e kandidatëve për ta marrë drejtimin e Shkëndijës së Tetovës. Lajmi u publikua në fillim nga "sportmedia.mk" dhe më pas u shpërnda me shpejtësi. Duke qëndruar në atë që raportojnë mediet lokale, Panucci ka marrë një ofertë të rëndësishme nga klubi tetovar, e cila vjen në të njëjtën kohë, kur flitet edhe për një ofertë tjetër në drejtim të italianit nga grekët e Aris të Selanikut. Pikërisht, nëse dështon pista e kampionatit helen, atëherë ish-tekniku i kombëtares shqiptare mund të afrohet më shumë me Shkëndijën. Kjo e fundit ende nuk e ka gjetur trajnerin e ri, që pas largimit nga detyra të Qatip Osmanit. Drejtuesit e klubit kanë një listë të gjatë kandidatësh, ndërsa pak kohë më parë në skenë doli edhe emri i teknikut të Skënderbeut, Ilir Daja.

### Van Dijk: Nuk mund të krahasohem me Messin

Ylli i Liverpoolit, Virgil van Dijk, ka thënë se nuk mund të krahasohet me Lionel Messin, duke hedhur poshtë çdo pretendim që ai ishte i zhgënjyer pasi fitoi çmimin e më të mirit nga FIFA. Van Dijk përfundoi i dyti pas superyllit të Barcelonës, Messit, për çmimin e së hënës, me sulmuesin e Juventusit dhe Portugalisë, Cristiano Ronaldo që zuri vendin e tretë. "Njerëzit që votojnë morën një vendim dhe ju duhet ta pranoni atë. Ky është rasti dhe si lojtar nuk mund të më krahasoni mua dhe Messin sepse është krejtësisht ndryshe. Jam shumë krenar që jam këtu", ka thënë Van Dijk.

### Ramosi kundër rikthimit të Mourinhos në Real

Jose Mourinho po lidhet me një rikthim te Real Madridi, pasi Zinedine Zidane nuk po tregon suksese në këtë fillim sezoni. Mirëpo kapiteni Sergio Ramos është kundër rikthimit Mourinhos në "Santiago Bernabeu". "Çdo gjë që lidhet me Real Madridin e mbush gazetën dhe mendoj se nuk duhet të thuhen gjëra që nuk qëndrojnë. Ne jemi të lumtur me punën e trajnerit dhe duhet të fokusohemi në ndeshjet e ardhshme për ta rritur edhe më shumë motivin për të fituar trofe në këtë sezon", ka thënë Ramosi.

### Juve interesohet për Willianin

Kampioni në fuqi i Italisë, Juventusi, ka shfaqur interesim për sulmuesin e Chelseat, Willian. Braziliani ka kontratë me skuadrën angleze deri në verën e vitit 2020 dhe deri me tash nuk ka filluar bisedimet për rinovimin e kontratës, prandaj Juventusi po planifikon ta transferojë brazilianin me parametra zero.

### Çështja 'Emiliano Sala', burg për dy anglezët

Tragjedia e Emiliano Sala ka lënë një boshllëk dhe një tronditje në botën e futbollit. Futbollisti që u zhduk gjatë një udhëtimi me avion rrugës për në ekipin e tij të ri, në transferimin nga Franca drejt Anglisë, ka shtangur të gjithë. Gjithsesi kishte nga ata që nuk kanë hezituar të shfrytëzojnë këtë çështje të dhimbshme për të përtuar famë. Bëhet fjalë për Sherry Bray dhe Christopher Ashford. Dy anglezë që nuk hezituan të fotografojnë dhe regjistrojnë autopsinë e realizuar mbi trupin pa jetë të argjentinasit, për ta publikuar më pas përmbajtjen në rrjetet sociale, pasi më parë kanë aksesuar në mënyrë të parregullt dokumente delikate. Këtë të hënë ka mbërritur dënimi për veprimet e tyre të paligjshme dhe pa etikë. Të dy personazhet janë dënuar me nga 14 dhe 5 muaj heqje lirie.

Autor: GAZMEND MORINA

KOMIKU ANGLEZ NË FOTO 1 | NJËRA NDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE | YLLI ME BISHT | ISH MAFIOZI .. KAPONE | ENDACAK | QYTET I LASHTË NË ILIRI | ZANORE | LLOJ SHPENDI ME QAFË TË GJATË | INDIUM | DRU QË RRITET NË VENDET MESDHETARE; LAR | ELEKTRON, SILIC




VEGËL DORE, QË PËRBËHET NGA NJË KOKË METALI | E VRULLSHME / GJOKS (FEM.)

PËRPJEKJE PËR TA MBROJTUR E PËRLIGJUR DIÇKA TË GABUAR E TË PADREJTË | VENDËS / FEMRA LUFTËTARE (mit. greke.)

VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE / KËNGËTARJA VEJSIU | INSEKT I MËRZITSHËM (sh.shq.) / BASHKËTING. | FINLANDA, ITALIA / MBETEM PA GOJË; SHASTISEM

SHTET AZIATIK / LUMË NË AUSTRI | QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI

INSTITUTE ANIMAL TECHNOLOGY | HUMORISTI BESIM / TRAJNERI HOLANDEZ ... HAN | KËNGËTARJA JONË E RE ... KOÇI / ASTAT

BASHKËTING. | SHKRONJA TË NJËJTA / HUQ; SHPREHI E KEQE | REKRUTËT NË PERANDORINË OSMANE / KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVRO-AZIATIK

AGIM VATOVCI | "RADIO TELEVISIONI ITALIAN" / QË NUK I PËRKET FESË DHE KLERIT | ATLETJA E NJOHUR MERLIN / DRAMË E SANTORIT | ZANORE / KRYEQYTETI I KANADASË | KËNGËTARJA JONË E RE KRASNIQI | QË KA TË BËJË ME HËNËN | FILM I YNI "... ISHIN KATËR" | VITI I RI KINEZ | LLOJ KARROCE ME KATËR RROTA, E TËRHEQUR PREJ KUAJSH

BIMË BARISHTORE SHUMË E HIDHUR | ESTONIA, NORVEGJIA / AGIM TEJECI | TONI / "RIMINI

LITËR; SULFUR; AMPER | VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE (sh.shq.) / FAMA | VEPRIMTARI MARTIN ..... KING / QYTET I MADH NË ZVICËR

INDIANA | MËRIA, ZILIA / ELEKTRODA E POLIT POZITIV | AFTËSIA E NJERIUT PËR TË KRIJUAR / KËNGËTARJA E SHQUAR FRENKLIN

SMIRË | KORNIZË / AKTORI SHQIPTARO-AMERIKAN NË FOTO 2 | PRODUKT I PULËS / SHTET FEDERAL NË SHBA | IDRIZ BALAJ / I FILLOJ

BASHKËTING. / PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR E NORMAVE JURIDIKE | HUNGAREZ (vjet.) / JEVG | QENGJI I BUTË / MOLDE | ZANORE / FUTBOLLISTI YNË BAJRAMI (shq.)

ZABEL | EMINE (perkdh.) / ELIZABETH BANKS | ERJON BOGDANI / ZANORE | NEON / BASHKËTING. | CILI MË RADHË

FUTBOLLISTI ITALIAN MASIMO (MILAN) | TRAJENRI SHOSHOLLI / ZANORE | RRAFSHIM; BARAZIM LARTËSISH (shq.) / NJË PLANET

FIGURË SHAHU | KA TË NGJARË, KUSHEDI | ARTIOLA TOSKA / KRYEPROK-URORJA E SHQIPËRISË ... RAMA | SILIC, SULFUR / ENË QELQI ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK




BASHKËTING. | GOJËTAR | KAMPIONI / SHKRONJA XVI | ADRIAN KRASNIQI | "RAGUZA" / FUTBOLLIST I NJOHUR I MANCHESTER UNITED

KLUB FUTBOLLI ANGLEZ | THEMELUESI I TURQISË MODERNE MUSTAFA ..... ATATURK | AKUZUES I SOKRATIT / LLOJ GAZI ME ERË TË FORTË

ERBIUM | U ZATETA / UNDERWATER ELECTRIC KITE | IPSVICH / ARRATISUR

KËNGËTARJA E NJOHUR PAUSINI | THIRRJA E MYEZINIT / SHKRONJA TË NJËJTA | NEVOJË E THEKSUAR QË KEMI PËR TË NGRËNË

SHALQI (shq.) / DY BASHKË-TINGËLLORE

ELEMENT KIMIK / JARAN | VEGËL MUZIKORE / SIENA | "URUGUAI" / ZANORE

"IRLANDA" | MËNYRË E VEÇANTË E TË VESHURIT | MUNDIMI; VËSHTIRËSIA

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: ÇEKAN, RAPIDE, APOLOGJI, ANAS, RIM, MIZAT, FI, ALKETA, OMANI, IAT, DINA, ENI, Ç, AA, NIZAMËT, AV, RAI, OTI, O, PELIN, EN, TONELATA, LSA, KAMARET, LUTER, I, INATI, IMAGJINATA, NAKAR, RAM, VEZA, IB, N, MAXHAR, MANARI, A, KORIJE, EMI, EB, NE, ODO, AJET, NIVELIMI, DAMA, MBASE, AT, SIS, S, ASI, AK, RA, BOLTON, ANIT, ER, U TAKOVA, I, LAURA, EZANI, RUTEN, IMONIKU, SHOK, PIANO, UR, IR, STIL, ZORI.

**Kërkesa për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: **"DITURIA" Ivajë**

Komuna: **Kaçanik**

Data: **25.09.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/148-CS/1.3** | **Trajnim: Zbatimi i TI në mësimdhënie** |

**Qeveria** e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **"DITURIA", Ivajë Kaçanik.**

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

**Trajnim: Zbatimi i Teknologjisë Informative në mësimdhënie (World, Exel dhe Power Point)**

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU **"DITURIA", Ivajë Kaçanik.**, më së largu deri më **08.10.2019.**

1. 4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**

**Nexhadi Luta**
**Telefoni : 044 224 878**
**E-mail: nexhadiluta@hotmail.com**

**Kërkesa për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: **"Bajram Curri" vendi Romaje**

Komuna: **Prizren**

Data: 25.**09.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës:Trajnim |
|---|---|
| ESIP/SDG/82 – CS/1.4 | Menaxhim,Administrim dhe udhëheqje në Arsim,te |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu"Bajram Curri" Romajë, Prizren.** Objektivi i nën-komponentit 1.2. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjajshme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu ''Bajram Curri" Romajë, Prizren, më së largu deri më datën: 03.10.2019** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë:

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Refki Demaj**
**Telefoni: 044/113196**
**E-maili:** refki-demaj@hotmail.com

**Njoftimi për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: ***"Krushë e Vogël"***

Komuna: **Prizren**

Data: **25.09. 2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/SDG/086-G/1.1** | **Pajisja teknologjike** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: **Shfmu "Krushë e Vogël" Krushë e Vogël, Prizren**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
   - ***Llaptop*** ***2 Copë***
   - ***Projektor me mbajtës*** ***3 Copë***
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: **Shfmu "Krushë e Vogël" Krushë e Vogël, Prizren,** më së largu deri më **03.10. 2019.**
4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues:Shpresa Shehu**
**Telefoni: 044/126 622, 044/215 970**
**E-maili: shehushpresa@live.com**

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Ngadhnjim Kastrati i lindur në Gjilan në 1979 shpall të pavlefshme diplomën e Komunikimit Masiv në Kolegjin AAB.

▶ Azize Veliu shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të shkollës së Muzikës "Prenk Jakova", Prishtinë të lëshuar me datë 8 qershor 1998.

▶ N.T.P Uka shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 71091155.

▶ Arjeta Rushiti shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda" Mitrovicë.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

## NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit se me datën 01. Tetor 2019 me fillim në orën 11:00 Kandidatja Mirjeta Salihaj, mbron punimin e Masterit me titull "Efektet ekonomike të prodhimit të qumështit në fermat e buallicave". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.

TREPÇA

**Republika e Kosovës - Republic of Kosovo**
**Trepça - Shoqëri Aksionare**
**Trepça - Deoničarsko Društvo**
**Trepça - Joint Stock Company**

Adresa: Parku industrial Mitrovicë, Tel. 028/538 050, 531 135, Fax: 028/539 202 web: www.trepcacorporation.org
Address: Mitrovica Industrial Park. Tel. 028/538 050, 531 135, Fax: 028/539 202 web: www.trepcacorporation.com

U skladu sa članom 8. Zakona o radu, članom 22. stav 4. Statuta Trepče, Administrativnim uputstvom br. 07/2017 o uređivanju postupaka konkursa u javnom sektoru i ukazanim potrebama za popunjavanjem odredjenih slobodnih radnih mesta, Trepca A.D. dana 24.09.2019 objavljuje:

## K O N K U R S

### Za popunjavanje slobodnih radnih mesta

**I. Radnici na proizvodnji rude:**

- 120 radnika u Starom Trgu i
- 30 radnika u Artani (Novo Brdo).

a) Obaveze i odgovornosti:
- Otkopovanje i izvoz rude;
- Izvoz rude lokomotivom ;
- Čišćenje kanala u rudniku;
- Otvaranje i popravljanje vertikalnih uskopa u rudniku

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:
- diploma osnovna / srednja škola;

II.Inxhinier i Elektroenergjetikës (2 pozita në Stan Tërg):
**II. Inženjer elektro-energetikee (2 pozicije u Starom Trgu):**

a) Obaveze i odgovornosti:

- vodi računa o elektro energetskim i razvodnim-distributivnim postrojenjima, postrojenjima za ventilaciju, postrojenja za proizvodnju komprimovanog vazduha, pumpnih postrojenja i izvoznih strojeva;
- održavanje postrojenja sa jednosmernim naponom kao što su industrijske baterije i lokomotive;
- sastavljanje redovnih izveštaja o radu u oblastima svojih odgovornosti i dužnosti;
- koordinira rad sa rukovodiocem održavanja i proizvodnje rude popravku masina i postrojenja;
- Planira snabdevanje elektro materijalom

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:
- Univerzitetska diploma inzenjera elektrotehnike-energetike.

III.Elektricist të Energjetikës (6 pozita në Stan Tërg):
**III.Električar za energetiku (6 izvrsioca u Starom Trgu):**

a) Obaveze i odgovornosti:

- Obavlja poslove održavanja elektro-energetska postrojenje u rudniku;

- Obavlja poslove održavanja kombinovana električna,elektronsku,pneumatska i hidraulična postrojenja sa razlicitim naponom;
- Obavlja dodatne dužnosti odredjene i povezane sa rukovodiocem
- sastavljanje redovnih izveštaja o radu u oblastima svojih odgovornosti i dužnosti.

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:
- srednjoškolska diploma;

**IV. Bravar (6 izvrsioca u Starom Trgu)**

a) Obaveze i odgovornosti:

- Nadzorise sistema odvodnjavanja pumpama u rudniku;
- Rukovodi sa pumnim postrojenjima (ukjucivanje i isklucivanje pumpi);
- Podešavanje i zamena cevovoda različitih prečnika;
- Popravljanje oštećenja na pumpama, ventilima i cevima;
- Zamenjuje sve vrste kvarova na mašinsku opremu;
- Zamena reduktora, pneumatskih motora, mehaničkih upravljačkih sistema;
- Zamena vagonskih sanduka, točkova, cilindar, cevi;
- Zamenjuje i prilagodjuje sve vrste rezervnih delova.
- Autogeno rezanje svih mehaničkih delova i konstrukcija;
- Sečenje metalnih cevi različitih prečnika u rudniku
- Autogeno zavarivanje raznih delova prema potrebi.

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:
- Srednjoškolska diploma;

**V.Rukovaoc pumpnih postrojenja (3 izvrsioca u Starom Trgu)**

a) Obaveze i odgovornosti:
- Rukovanje pumpim postrojenjima (ukjucivanje i isklucivanje pumpi);
- Regulise ventile i količine ispumpane vode iz rudnika;
- Zatvara i otvara prema potrebi vodena vrata u XI horizontu;
- Kontinuirano praćenje nivoa vode tokom svoje smjene.

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:
- Srednjoškolska diploma

VI.Inxhinier i makinerisë (1 pozitë në Stan Tërg)

**VI.Mašinski inženjer (1 izvrsioc u Starom Trgu)**

a) Obaveze i odgovornosti: - Vrši mehaničke popravke alata, mašina i opreme;
- Planira, organizuje i odredjuje prednosti prilikom nabavke rezervnih delova;
- Planira i organizuje testiranje opreme u skladu sa tehničkim pravilima;
- Organizuje, sistemuje i čuva stručnu literaturu i tehničku dokumentaciju za postojeći alat, mašine i opremu;

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:
- Univerzitetska diploma inženjera mašinstva

**VII.Mašinski tehnicar (4 izvrsioca u Starom Trgu)**

a) Obaveze i odgovornosti:

- Obavlja snimanje delova, crtanje, kopiranje i obradu tehničke dokumentacije za postojeću opremu i nove konstrukcije;
- Umnožava i obezbedjuje potreban broj kopiranih crteža i iste sistemuje i deli prema vrsti mašina, na mestima koja su za to odredjena;
- Prati vreme korišćenja mašina, odnosno potrošnju materijala i rezervnih delova, na osnovu dnevnih izveštaja o sluzbe glavnog i internog magacina.;
- Obavlja i druge poslove po nalogu rukovodioca tehničke pripreme,tehicke konstrukcije i tehnicke kontrole kome direktno odgovoran za svoj rad.

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:

- Univerzitetska diploma inženjera mašinstva ili diploma srednje tehničke škole.

**VIII Tehničar energetike (4 izvrsioca u Starom Trgu)**

a) Obaveze i odgovornosti:
- obavljanje sve električne poslove i zadataka koje odredjene od nadzornog osoblja;
- Popravlja instalacije i uredjaje za osvetljenje u pogonu;
- Pomaze u popravljanju električnih kvarova u pogonu;
- Zajedno sa brigadom vrši popravke u celom pogonu;
- Vrsi nove instalacije pod nadzorom brigadira.

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:

- Univerzitetska diploma inženjera energetike ili diploma srednje tehničke škole,Tehničar energetike.

**IX.Rudarski inženjer (1 izvrsioc u Starom Trgu)**

a) Obaveze i odgovornosti:
- Priprema mesečne operativne planove;
- Nalazi tehnološka resenja u cilju postizanja proizvodnje i radi u skladu sa dogovorom i uputstvima rukovodioca;
- U saradnji sa drugim službama planiraju godišnje i mesečne popravke rudarske opreme;

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija

- Univerzitetska diploma inženjera rudarstva

**X. Električni i Autogeni Varioci (2 izvrsioca u Starom Trgu)**

a) Obaveze i odgovornosti:

- Zavarivanje spojeva i konstrukcija;
- Zavarivanje cevi i opreme za grejanje;
- Zavarivanje čeličnih delova, zavarivanje pripremljenih delova, zavarivanje raznih konstrukcija itd.
- Zavarivanje ograda, kranskih točkova, postolja i raznih delova koji se obrađuju;
- zavarivanje delova koji izuskuje čisto zavarivanje odnosno zavarena mesta nisu opterećena visokim pritiskom;
- Sečenje autogenim materijalom širine do 20 mm;
- Zavarivanje jednostavnih usisnih delova;
- Zavarivanje delova koji se ne obrađuju;
- Sam priprema opremu za zavarivanje;
- Obavlja i druge dužnosti prema nalogu rukovodioca.

b) Specifični uslovi i potrebna dokumentacija:
- Diploma srednje škole

**XI.Metalo strugar ( 2 izvrsioca u Starom Trgu)**

a) Obaveze i odgovornosti:
